

VLERËSIMI I KOMPETENCAVE TË NXËNËSVE NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT

Modele dhe shembuj nga mësuesit në arsimin të mesëm të
ulët

2019

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
I. Kompetencat dhe zhvillimi i tyre në arsimin parauniversitar.....	3
Kompetencat kyç për nxënien gjatë gjithë jetës	4
Përshkrimi i kompetencave kyç nëpërmjet rezultateve të të nxënësve.....	4
Lidhja e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës	9
II. Kuptimi mbi vlerësimin e nxënësve në arsimin parauniversitar.....	10
Parimet themelore të vlerësimit.....	10
Çfarë vlerësojmë?.....	11
III. Procedura dhe llojet e vlerësimit të nxënësve në AMU (klasat 6-9).....	11
Vlerësimi i vazhduar (vlerësimi për të nxënësve)	12
Vlerësimi i portofolit lëndor të nxënësve.....	13
Vlerësimi i të nxënësve (testi/detyra përmbledhëse).....	15
Vlerësimi periodik	15
Vlerësimi përfundimtar	16
IV. Modele vlerësimi të nxënësve në disa fusha të nxënësve ose lëndë mësimore	16
Vlerësimi i nxënësve në lëndën “Gjuhë shqipe”	16
Vlerësimi i nxënësve në lëndën “Matematikë”	27
Vlerësimi i nxënësve në fushën “Shoqëria dhe mjedisi”.....	39
Vlerësimi i nxënësve në fushën “Shkencat e natyrës”	Error! Bookmark not defined.
V. Ndryshimet pozitive që sjell vlerësimi i bazuar në kompetenca.....	68
VI. Fjalorth për vlerësimin e nxënësve.....	69
VII. Bibliografia	73

Hyrje

Udhëzuesi për vlerësimin e kompetencave në arsimin e mesëm të ulët (AMU) është një material ndihmës për mësuesit e klasave 6-9. Ai ka për qëllim:

- të zbërthejë dhe të sqarojë konceptin e kompetencave kyç dhe lëndore;
- të qartësojë mësuesit për parimet e vlerësimit të kompetencave;
- të ndihmojë mësuesit në përzgjedhjen e llojeve, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit që synojnë zhvillimin dhe vlerësimin e kompetencave të lëndëve dhe kompetencave kyç;
- të udhëzojë mësuesit në procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve, duke u bazuar në rezultatet e të nxënësve të kompetencave kyç dhe të kompetencave lëndore, si dhe në nivelet e arritjeve;
- të ofrojë modele dhe shembuj të vlerësimit të nxënësve në fusha të ndryshme të nxëni.

Struktura e udhëzuesit është pasqyruar më poshtë:

Udhëzuesi:

- përshkruan rëndësinë e zhvillimit të kompetencave për të nxënësit gjatë gjithë jetës;
- liston dhe përshkruan kompetencat kyç dhe lëndore që zhvillohen në programet lëndore në AMU;
- sqaron parimet dhe llojet e vlerësimit të kompetencave;
- shtjellon teknikat dhe instrumentet e vlerësimit të nxënësve;
- ofron modele të vlerësimit të kompetencave në fusha të nxëni/ lëndë të ndryshme.

Udhëzuesi përqendrohet më shumë te shembujt, modelet dhe ilustrimet, në mënyrë që t'i shërbejë sa më mirë veprimtarisë së përditshme të mësuesit.

Udhëzuesi u përgatit nga punonjës të IZHA-s në bashkëpunim me drejtues rrjetesh dhe me mësues nga DAR/ZA të ndryshme të vendit. Hartimi dhe botimi i tij u mundësua nga KulturKontakt Austria.

I. Kompetencat dhe zhvillimi i tyre në arsimin parauniversitar

Me ndryshimet që ndodhin në shoqëri, shfaqen nevoja të reja, marrëdhënie të reja në shoqëri dhe në tregun e punës, risi teknologjike, aspirata të reja njerëzore, strategji të reja për zhvillim etj. Këtyre ndryshimeve, arsimit duhet t'u përgjigjet me ritme të shpejta, me zhvillime të brendshme sasiore e cilësore, për të mundësuar njohuri të reja, shkathtësi, vlera dhe qëndrime të përshtatshme, sistematike, koherente dhe në zhvillim të përhershëm.

Në këto kushte, nevoja për ndryshime kurrikulare që synojnë kompetencat, u rishfaq gjithnjë e më shpesh si domosdoshmëri në fushën e politikave arsimore dhe praktikën shkollore. Arsimit parauniversitar duhet të krijojë kushte dhe mundësi që nxënësve të ndërtojnë dhe të zhvillojnë

njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Kompetencat kyç për nxënien gjatë gjithë jetës

Zhvillimet e sipërpërmendura dhe nevojat për ndryshime arsimore e bëjnë të qartë domosdoshmërinë për të nxënë gjatë gjithë jetës. Qytetarëve të shoqërisë së dijes u nevojitet të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet vetjake, shoqërore dhe ato që lidhen me botën e punës dhe tregun e lirë. Procesi i arsimimit do t'i mundësojë çdo nxënësi zotërimin e kompetencave kyç, të nevojshme për jetën dhe punën. Kompetencat shprehen nëpërmjet përdorimit të njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave të kontekstit.

Rrugët dhe mënyrat me të cilat njerëzit i qasen sot informacionit dhe shërbimeve ndryshojnë vazhdimisht. Për këtë arsye, të gjitha moshat kanë nevojë të pajisen me kompetenca të reja që i ndihmojnë të përshtaten në botën e sotme digjitale, jo vetëm nëpërmjet fitimit të njohurive dhe aftësive teknike, por edhe nëpërmjet të kuptuarit të thellë të mundësive, sfidave dhe çështjeve etike, ligjore dhe shoqërore që lindin ose shoqërojnë zhvillimet e reja ekonomike, shoqërore dhe teknologjike.

Këto ndryshime shtrojnë domosdoshmërinë e zotërimit të kompetencave që i aftësojnë individët të menaxhojnë ndryshimet dhe situatat e reja.

Në përputhje me qëllimet e arsimit parauniversitar, këto kompetenca janë:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;
- Kompetenca e të menduarit;
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë;
- Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin;
- Kompetenca personale;
- Kompetenca qytetare;
- Kompetenca digjitale.

Përshkrimi i kompetencave kyç nëpërmjet rezultateve të të nxënës

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: Me qëllim që fëmijët dhe të rinjtë të zhvillojnë personalitetin, të nxënë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri, është me rëndësi që t'i kuptojnë mesazhet që u drejtohen dhe të shprehen në mënyrë të përshtatshme me anë të gjuhëve, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave artistike. Për t'u bërë komunikues efektivë, nxënësit ndihmohen që të

shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe krijuese mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit.

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit, e shprehur nëpërmjet rezultateve të të nxënësve

Nxënës:

- komunikojnë dhe shprehen me anë të gjuhëve, simboleve, shenjave dhe kodeve;
- flasin, dëgjojnë, lexojnë dhe shkruajnë në gjuhën amtare dhe në (së paku) një gjuhë tjetër të huaj;
- përfshihen dhe kontribuojnë në dialog të respektueshëm dhe produktiv;
- japin dhe marrin informacion në mënyrë konstruktive dhe krijuese;
- respektojnë rregullat e përgjithshme të komunikimit/ndërveprimit dhe njëkohësisht dhe janë krijues;
- përdorin TIK-un dhe mediet në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme si mjete të rëndësishme të informimit, të komunikimit dhe të ndërveprimit në epokën digjitale.

Kompetenca e të menduarit: Marrja dhe përpunimi i njohurive në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi është shumë e rëndësishme për të nxënë, por edhe për të marrë vendime dhe për të zgjidhur probleme. Duke mbajtur parasysh kompleksitetin e shoqërisë dhe ekonomisë së sotme, të bazuar në dije, menaxhimi i dijes është bërë kompetencë thelbësore për shekullin XXI. Nxënësit kanë nevojë jo vetëm që të marrin informacion, por edhe të zhvillojnë aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese.

Kompetenca e të menduarit, e shprehur nëpërmjet rezultateve të të nxënësve

Nxënës:

- identifikojnë, lokalizojnë dhe përdorin informacionin e duhur;
- përpunojnë në mënyrë kritike informacionin (analizojnë, sintetizojnë, organizojnë, shfrytëzojnë dhe zbatojnë);
- zbatojnë hapat për zgjidhjen e problemit;
- gjejnë drejt, në bazë të analizës dhe sintezës paraprake të fakteve e situatave;
- ilustrojnë me mjete konkrete të menduarit abstrakt;
- vlerësojnë mundësitë e ndryshme dhe marrin vendime të drejta;
- lidhin në mënyrë të përgjegjshme vendimet e tyre me pasojat;
- vlerësojnë cilësinë, rëndësinë dhe vlerën e informacionit, kundrejt qëllimit për të cilin nevojitet ky informacion;
- vlerësojnë paraqitjen vetjake përkundrejt rezultateve të pritshme;
- menaxhojnë informacionin në mënyrë kritike, krijuese dhe të përgjegjshme;
- zgjidhin problemet në nivelin e caktuar të vështirësisë.

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: Në zhvillimet bashkëkohore në shoqëri, në shkencë, në teknologji e në ekonomi nuk mund të kërkohej që të gjitha njohuritë, shkathhtësitë e qëndrimet e

nevojshme të arrihen nëpërmjet shkollimit. Prandaj, shkolla u krijon nxënësve të gjitha kushtet dhe mundësitë për t'u arsimuar dhe përgatitur për të nxënë gjatë gjithë jetës.

Shkolla i ndihmon fëmijët dhe të rinjtë të kultivojnë kërkueshmëri dhe interesin për dije dhe të zhvillojnë kompetencën për të nxënë. Në funksion të kësaj kompetence, shkolla duhet të ndërtojë një kulturë të ndërgjegjshme për rëndësinë e stileve dhe strategjive efektive të të nxënit.

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë, e shprehur nëpërmjet rezultateve të të nxënit

Nxënësit:

- vlerësojnë nevojën për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- demonstrojnë shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, matematikë, shkenca, TIK dhe në situatat e jetës së përditshme;
- identifikojnë stilet e strategjitë e parapëlqyera të të nxënit;
- ndërtojnë njohuritë e reja mbi njohuritë e tyre të mëparshme;
- vendosin përparësi në qëllimet e të nxënit;
- ndjekin përparimin e tyre dhe bëjnë ndërhyrjet e domosdoshme për t'u përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme;
- janë më të motivuar për të nxënit e mëtejshëm;
- shfrytëzojnë teknologjinë për të nxënë;
- kërkojnë dhe shfrytëzojnë këshillat, informacionin dhe ndihmën, kur është e nevojshme;
- ndërmarrin nisma, vlerësojnë rreziqet dhe përballen me vështirësi gjatë nxënies;
- menaxhojnë në mënyrë produktive dhe të përgjegjshme burimet që kanë në përdorim;
- bashkëpunojnë me të tjerët, menaxhojnë konfliktet;
- veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme;
- vlerësojnë në mënyrë kritike punën e tyre duke iu referuar qëllimeve fillestare.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: Shkollat përgatitin nxënësit për të jetuar, për të punuar në një botë të ndërlidhur dhe për t'u ballafaquar me ekonominë konkurruese globale. Jeta dhe puna në shekullin XXI kërkon kompetenca për t'u përballur me rrethana dhe sfida të paparashikuara, si dhe kapacitete për të shfrytëzuar mundësitë që ofrohen për zhvillimin vetjak, përparimin e shoqërisë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Për të zhvilluar këtë kompetencë, shkolla iu krijon nxënësve kushte që të kuptojnë tërësisht ndërvarësinë ndërmjet dukurive ekonomike, politike dhe kulturore të shoqërisë vendore dhe globale. Ajo mundëson që nxënësit të orientohen drejt së ardhmes, të zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes dhe të jenë të motivuar për të përmbushur objektivat. Njëkohësisht, shkolla i ballafaqon nxënësit me problemet ekologjike, për t'i ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin, e shprehur nëpërmjet rezultateve të të nxënit

Nxënësit:

- paraqesin veten me shkrim dhe me gojë, duke përpiluar CV-në (biografinë) në formatet e kërkuara;
- demonstrojnë kompetencat e nevojshme për situatat e ndryshme jetësore dhe drejtimit e ndryshme të karrierës;
- hulumtojnë dhe shfrytëzojnë mundësi për arsimim, për përgatitje profesionale si dhe për këshillim;
- demonstrojnë shkathtësi organizative, marrin nisma dhe punojnë në grup;
- planifikojnë dhe menaxhojnë projekte për të arritur objektiva të caktuara (udhëheqin, delegojnë, analizojnë, komunikojnë, raportojnë, vlerësojnë, monitorojnë, udhëzojnë);
- identifikojnë dhe vlerësojnë burimet e nevojshme (p.sh., kohën, mjetet financiare, burimet njerëzore);
- tregojnë fleksibilitet, shpirt krijues, përgjegjshmëri për t'iu përshtatur rrethanave të reja, gjatë realizimit të një detyre;
- ndërmarrin nisma;
- demonstrojnë solidaritet dhe konkurrojnë me ndershëmëri, gjatë realizimit të detyrave të caktuara.

Kompetenca personale: Për të zhvilluar kompetencën personale, shkollat përgatisin nxënësit të përfshihen në mënyrë efektive në jetën familjare e shoqërore dhe në punë. Në këtë kontekst, nxënësit përkrahen të ndërgjegjësohen për veten, të kenë vetëbesim, të jenë të hapur dhe të kenë besim tek të tjerët.

Kompetenca personale, e shprehur nëpërmjet rezultateve të nxënësve**Nxënësit:**

- demonstrojnë vetëbesim dhe shkathtësi personale e ndërpersonale;
- njohin përparësitë dhe dobësitë e tyre;
- zhvillohen duke u mbështetur në përparësitë e tyre dhe punojnë për kapërcimin e dobësive;
- menaxhojnë emocionet e tyre;
- bashkëpunojnë dhe mirëkuptojnë të tjerët;
- njohin, respektojnë dhe çmojnë kulturën e tyre si dhe vlerat, besimet dhe kulturat e të tjerëve;
- shmangin paragjykimet dhe bëjnë kompromise;
- menaxhojnë stresin, traumat dhe zgjidhin në mënyrë konstruktive konfliktet me të tjerët;
- kuptojnë dhe u përmbahen kodeve të sjelljes, në situata të ndryshme;
- jetojnë në mënyrë të shëndetshme;
- bëjnë zgjedhje dhe marrin vendime të informuara lidhur me shëndetin, dietat dhe ushtrimet;
- ndjekin planet vetjake të jetesës dhe vlerësojnë shkallën e arritjes së qëllimeve të synuara;
- veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme, të vetëdijshëm për pasojat e veprimeve të tyre.

Kompetenca qytetare: Të mësuarit për të jetuar së bashku trajtohet si sfida kryesore e botës së sotme dhe së nesërme. Qytetaria shtetërore sot plotësohet me aspektin shumë të rëndësishëm të “qytetarisë globale”. Kjo kompetencë siguron që nxënësit të jenë në gjendje të veprojnë si qytetarë të përgjegjshëm, duke marrë parasysh kontekstin e ngushtë dhe të gjerë.

Kompetenca qytetare, e shprehur nëpërmjet rezultateve të nxënit

Nxënësit:

- kuptojnë ligjësitë e zhvillimit të mjedisit të tyre shoqëror dhe mënyrën e funksionimit të tij (p.sh., strukturën, kulturën, shprehitë, rregullat dhe pritshmëritë);
- mbështetin të drejtat e njeriut, si bazë e demokracisë;
- ushtrojnë të drejtat e tyre dhe respektojnë të drejtat e të tjerëve;
- vlerësojnë shumëllojshmërinë dhe demonstrojnë tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve;
- menaxhojnë dhe zgjidhin konfliktet në mënyrë konstruktive;
- marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes demokratike në të gjitha nivelet (p.sh., në familje, në shkollë, në komunitet, si dhe në proceset e politikave vendore dhe shtetërore);
- demonstrojnë vlerat dhe parimet e të drejtave të njeriut në jetën e përditshme (p.sh., respekti i dinjitetit vetjak, shmangia e paragjykitimeve dhe diskriminimit të të gjitha llojeve, promovimi i barazisë gjinore);
- tregojnë interes për çështjet publike dhe kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve në nivel shkolle dhe komuniteti;
- mbrojnë mjedisin dhe kontribuojnë për zhvillimin e tij të qëndrueshëm.

Kompetenca digjitale: Kompetenca digjitale nënkupton përdorimin kritik dhe efektiv të TIK-ut në punë, gjatë kohës së lirë dhe gjatë komunikimit. Ajo mbështetet në shkathtësitë themelore të përdorimit të kompjuterit për të gjetur, prodhuar, krijuar, prezantuar dhe shkëmbyer informacion, si dhe për të bashkëpunuar në rrjetet informuese në internet.

Kompetenca digjitale e shprehur nëpërmjet rezultateve të nxënit

Nxënësit:

- ndërveprojnë dhe bashkëpunojnë me moshatarët, ekspertët apo të tjerët duke përdorur shumëllojshmërinë e medieve digjitale;
- përdorin media dhe formate të ndryshme për komunikimin e informacionit dhe ideve në mënyrë efektive për audiencë të shumta;
- zhvillojnë vetëdijen/ndërgjegjësimin mbi globalizimin dhe larminë kulturore duke u përfshirë në ndërveprim me nxënës nga kulturat e tjera;
- kontribuojnë në rritjen e rendimentit të punës në grupet e projekteve për të sjellë produkte origjinale apo për të zgjidhur probleme;
- ruajnë etikën e komunikimit personal dhe në grupi;
- gjejnë, organizojnë, analizojnë, vlerësojnë, përpunojnë dhe përdorin informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;

- përzgjedhin burimet e informacionit apo mjetet digjitale bazuar në përshtatshmërinë e tyre për kryerjen dhe zgjidhjen e një sërë detyrash (apo problemesh të veçanta);
- ruajnë sigurinë e identitetit virtual dhe privatësinë personale;
- përzgjedhin dhe përdorin aplikacionet në mënyrë efektive dhe produktive;
- zgjidhin problemet e sistemeve dhe aplikacioneve;
- kuptojnë dhe përdorin saktë sistemet e teknologjisë.

Lidhja e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës

Realizimi i kompetencave kyç të kornizës kurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyç me kompetencat e lëndës për secilën shkallë. Për ta realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat, strategjitë dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënit. Kur nxënësi përmbush kompetencat lëndore, ai është duke ndërtuar dhe duke zhvilluar njëkohësisht edhe kompetencat kyç. P.sh., gjatë prezantimeve të ndryshme në orët mësimore të gjuhës shqipe, nxënësi përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit dhe zhvillon kështu edhe kompetencën digjitale ose p.sh., kompetenca matematikore “Zgjidhja e situatës problemore” përfshin shumë nga strategjitë e zgjidhjes së situatave të ndryshme problemore në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyç në këndvështrimin e domosdoshmërisë së tyre në jetë, në shoqëri dhe në punë.


Më konkretisht, për të realizuar lidhjen e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës, mësuesi ndjek këta hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyç që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetenca kyç për secilin vit mësimor rezultatin/et e të nxënit për shkallë për kompetencat kyç;
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizohen rezultatet e të nxënit;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t’i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave dhe projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor.

II. Kuptimi mbi vlerësimin e nxënësve në arsimin parauniversitar

Vlerësimi në arsim është procesi gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati arsimor, mbi bazën e një kriteri të caktuar.

Qëllimi kryesor i vlerësimit është marrja e vendimeve që synojnë përmirësimin e rezultateve të të nxënësve dhe vetë procesin e të nxënësve. Marrja e vendimeve kërkon grumbullimin e vazhdueshëm të informacionit për të matur dhe për të vlerësuar të gjitha aspektet e procesit. Praktikën e vlerësimit kanë ndikim vendimtar në procesin e të nxënësve.



Parimet themelore të vlerësimit

Vlerësimi bazohet në parime të caktuara, si:

Vlefshmëria

Vlerësimi duhet të sigurojë informacion të vlefshëm për proceset, për rezultatet dhe për vlerat që zhvillohen nga nxënësve gjatë procesit të arsimimit në nivele të ndryshme.

Transparenca

Nxënësve kanë të drejtë dhe nevojë të njihen me kriteret dhe metodat me të cilat do të vlerësohen. Kjo garanton paanshmërinë e vlerësimit dhe ndihmon të nxënësve. Kriteret e qarta dhe të hapura ndihmojnë gjykimet profesionale, si dhe sigurojnë që vendimet të shqyrtohen nga të gjithë dhe të jenë të qëndrueshme.

Paanshmëria

Vlerësimi i paanshëm nënkupton vlerësimin e një rezultati të të nxënësve, duke mos u ndikuar nga karakteristikat dhe rrethanat e çdo nxënësi, të cilat përfshijnë: gjininë, etninë, gjuhën, racën, rrethanat ekonomike e shoqërore, vendndodhjen, si dhe personalitetin, talentin, aftësitë e kufizuara etj.

Besueshmëria

Gjykimet për përparimin e nxënësve duhet të bazohen në lloje dhe burime të ndryshme informacioni. Informacioni i marrë nga vlerësimi duhet të tregojë në mënyrë të besueshme, nëse nxënësi është në gjendje të realizojë atë çfarë përshkruhet në rezultatet e të nxënit. Integrimi i llojeve dhe i burimeve të ndryshme të të dhënave të mbledhura gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe në situata të ndryshme është kusht i domosdoshëm për të siguruar gjykime të qëndrueshme dhe të paanshme për arritjet e nxënësve.

Çfarë vlerësojmë?

Aspektet e të nxënit

Të nxënit e planifikuar realizohet në kontekste, mjedise dhe mënyra të ndryshme. Kontekstet përfshijnë etosin dhe jetën e shkollës si komunitet, fushat e të nxënit dhe lëndët përkatëse, të nxënit ndërkurrikular dhe mundësitë individuale. Ato përfshijnë të nxënit, si brenda ashtu edhe jashtë mjediseve shkollore. Vlerësimi i nxënësit fokusohet në njohuritë, shkathhtësitë, qëndrimet dhe vlerat, që janë përcaktuar në programet lëndore.

Pritshmëritë

Pritshmëritë shprehen në formën e rezultateve të të nxënit në kurrikul, për nivele dhe shkallë, të cilat duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit.

Vlerësimi duhet t'i aftësojë dhe t'i motivojë të gjithë nxënësit për të zhvilluar potencialin e tyre në të gjithë kurrikulën.

Nxënësit mund të përparojnë me ritme të ndryshme: disa kërkojnë mbështetje dhe kohë për të arritur rezultatet e të nxënit në një ose disa fusha/lëndë në një shkallë të caktuar; disa të tjerë përparojnë më shpejt dhe kërkojnë detyra më të avancuara dhe pavarësi në të nxënë.

III. Procedura dhe llojet e vlerësimit të nxënësit në AMU (klasat 6-9)

Vlerësimi është procesi gjatë të cilit *mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së rezultateve të të nxënit, duke u bazuar në nivelet e arritjes. Qëllimi kryesor i vlerësimit është përmirësimi i përmbushjes së rezultateve të të nxënit nga nxënësi dhe i vetë procesit të të nxënit.*

Vlerësimi përdoret:

- për të gjykuar mbi përpjekjet e nxënësve për të nxënë;
- për të motivuar dhe për të nxitur nxënësit për të nxënë;
- për të gjykuar, reflektuar dhe përmirësuar procesin e mësimdhënie -nxënies;
- për të matur arritjet e nxënësve;
- për të raportuar arritjet;

- për t'u dhënë sugjerime nxënësve për përparimin e tyre;
- për t'u dhënë sugjerime prindërve mbi përparimin e fëmijëve të tyre.

Vlerësimi i nxënësit kryhet nëpërmjet:

- vlerësimin të vazhduar (vlerësimi për të nxënë) (40%);
- vlerësimin me test/detyrë përmbledhëse (vlerësimi i të nxënësve) (40%);
- vlerësimin të portofolit lëndor të nxënësit (20%).

Vlerësimi i vazhduar (vlerësimi për të nxënë)

Vlerësimi për të nxënë shpesh quhet *vlerësim formues* dhe është vlerësim që mbledh të dhëna dhe dëshmi rreth të nxënësve gjatë procesit të të nxënësve. Ky lloj vlerësimi mundëson që mësuesi të identifikojë pikat e forta të nxënësve, problemet dhe vështirësitë që ata kanë dhe të japë reagime të menjëhershme, të cilat i ndihmojnë nxënësit të mësojnë më mirë. Gjithashtu, vlerësimi për të nxënë ndihmon mësuesin të planifikojë punën për të zhvilluar mësimin në mënyrë më efektive. *Shpesh ky vlerësim është informal* dhe nxënësit mund të mbajnë edhe vetë shënime mbi progresin e tyre. Një shembull është një kuiz i shpejtë për të parë nëse nxënësit i kujtojnë pikat e rëndësishme të mësimin. Ndryshimi kryesor që ka ndodhur në vlerësimin e nxënësit gjatë zbatimit të kurrikulës së re është vlerësimi për të nxënë (vlerësimi i vazhduar). *Fokusi kryesor i vlerësimin për të nxënë (vlerësimin të vazhduar) është që nxënësi të përmirësojë të nxënësit e tij, si dhe të motivohet më shumë për të mësuar.* Pra, vlerësimi për të nxënë nuk ka si qëllim kryesor vendosjen e një note, por të evidentojë te nxënësi pikat e forta dhe problematikat dhe ta ndihmojë që t'i përmirësojë ato. Në këto kushte, mësuesi duhet të fokusohet te procesi i të nxënësit dhe jo te vendosja e notës.

Si dokumentohet vlerësimi i vazhduar (vlerësimi për të nxënë)?

- Fletorja personale dhe evidenca nënkuptojnë *të njëjtin dokument*. Pra, mësuesi ka vetëm një dokument për vlerësimin e vazhduar (vlerësimin për të nxënë).
- Mësuesi mban shënime në fletoren e tij personale (apo në evidencë) ecurinë e progresit të nxënësit lidhur me rezultatet e arritjes.
- Fletoren personale (evidencën) mësuesi *e formaton në mënyrën më të përshtatshme për të*, por duke ruajtur logjikën e vlerësimin për të nxënë. Me fletoren personale (evidencën) mësuesi është i lehtësuar nga ngarkesa ose nga presioni për të vënë nota në regjistër në mënyrë të vazhduar.
- Mësuesi është i lirë t'i mbajë shënimet në fletoren e tij personale (evidencë) duke vendosur *simbolet, që ai gjykon si të përshtatshme*, të shoqëruara me komente shumë sintetike, të cilat iu referohen niveleve të arritjes së kompetencave lëndore.

- Komenti përmban nivelin e arritjes duke e shënuar me simbolin përkatës (p.sh., N₃ ose N₄), si dhe *konceptin/konceptet përkatëse* për të cilin është vëzhguar nxënësi.
- Përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, punët individuale, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimi i nxënësit, vlerësimi i nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjet në aktivitete dhe diskutimet në klasë, detyrat e shtëpisë apo të klasës etj., *vlerësohen me simbole*. Vendosja e notës në mënyrë të vazhduar gjatë vlerësimit për të nxënë nuk ndihmon procesin e të nxënësve, motivimin e nxënësve për të nxënë dhe zhvillimin e kompetencave.
- Nota në fletoren personale (evidencë) mund të vendoset **vetëm** në raste specifike, siç janë testet e ndërmjetme apo punët me shkrim etj.
- Nota e vlerësimit të vazhduar që vendoset në regjistër në faqen “Vlerësimi periodik” duhet të jetë *rezultante progresive (ose regresive) e vlerësimeve që mësuesi ka mbajtur në fletoren e tij personale*.
- Fletorja personale (evidenca) është objekt monitorimi, por nuk duhet dorëzuar në përfundim të periudhës.
- Mësuesi mban përgjegjësi për fletoren personale dhe duhet të argumentojë notën e vlerësimit të vazhduar të vendosur në regjistër.
- Mësuesi duhet të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor fletoren personale (evidencën), teste/detyra të ndërmjetme, punët me shkrim, etj. Këto do t’i shërbejnë për të argumentuar notën e vlerësimit të vazhduar.
- Drejtuesit e shkollave nuk duhet të ngarkojnë mësuesit me detyrimin për të mbajtur dy dokumente për vlerësimin e vazhduar të nxënësve: evidencën e vlerësimit të vazhduar dhe fletoren personale të shënimeve, ato janë e njëjta gjë.
- Gjatë periudhës, mësuesi i lëndës ka përgjegjësi për të informuar nxënësin për ecurinë dhe mundësinë e tij për progres.

Vlerësimi i portofolit lëndor të nxënësit

Portofoli është koleksionim sistematik i detyrave dhe i punimeve të kryera nga nxënësi për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohurive, shkathtësive, qëndrimeve). Portofoli i nxënësit duhet të përmbajë detyra hulumtuese, krijime ose zbatime të ndryshme, projekte të nxënësve etj., që zhvillojnë *kompetencat kyç dhe lëndore*. Detyrat e portofolit nuk janë pjesë e vlerësimit të vazhduar të nxënësit. ***Për një periudhë, detyrat që vlerësohen në portofol janë:***

- Projektin ose një fazë e tij, e cila është pjesë e detyruar e portofolit për çdo periudhë.
- 1 -2 detyra krijuese, zbatuese, hulumtuese etj.

(P.sh., në lëndët me 1-2 orë në javë portofoli mund të përmbajë një detyrë hulumtuese dhe një fazë të projektit lëndor ose gjithë projektin, ndërsa lëndët me më shumë se 2 orë, portofoli mund të përmbajë 2 detyra hulumtuese dhe një fazë të projektit lëndor ose gjithë projektin, nëse është projekt i vogël). Detyrat e portofolit duhet të jenë me të njëjtën temë për çdo nxënës. Detyrat e portofolit mund të jenë punime të kryera në klasë dhe/ose jashtë saj, dëshmi e kontributeve dhe talentit të nxënësit, me karakter hulumtues dhe krijues të tilla si:

- punë praktike individuale,
- produkte të krijuara nga nxënësit,
- punime audio-vizuale,
- aktivitete në grup ose individuale;
- projekte individuale ose në grup;
- etj.

*Kujdes! Detyrat **NUK** duhet të jenë domosdoshmërisht të punuara me kompjuter.*

Si dokumentohet dhe vlerësohet portofoli?

- Në fillim të periudhës, mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, përcaktojnë detyrat që do të përfshijnë në portofol përgjatë periudhës, në varësi të specifikave të lëndës.
- Mësuesi përcakton kriteret e vlerësimit të portofolit.
- Mësuesi në fillim të periudhës përcakton dhe iu prezanton nxënësve peshat/pikët për vlerësimin e secilës detyrë të portofolit dhe kriteret e vlerësimit të tij.
- Vlerësimi i secilës detyrë të portofolit bëhet mbi bazë të kriterëve që mësuesi vendos, duke u bazuar në llojin e detyrës së dhënë.
- Mësuesi ka përgjegjësi për vlerësimin e portofolit bazuar në kriteret e vlerësimit duke argumentuar notën e tij.
- Instrumentet që mësuesi harton për kriteret e vlerësimit të portofolit *nuk janë objekt monitorimi.*
- Detyrat e portofolit apo një fazë e projektit vlerësohen në momentin që ato dorëzohen ose prezantohen.
- Vlerësimi i portofolit mund të planifikohet si orë e veçantë në planifikimin e periudhave ose mund të realizohet përgjatë tri - katër orëve mësimore të periudhës.
- Mësuesi duhet të kujdeset që të mos mbingarkojë nxënësin me detyra në përfundim të periudhës. Ai, gjithashtu, mund të bashkërendojë punën me mësuesit e lëndëve të tjera për të shmangur ngarkesën e nxënësve.
- Vlerësimi i portofolit *jodomosdoshmërisht* bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e gjykon vetë kohën se kur do të zhvillojë vlerësimin e portofolit.

- Në momentin që mësuesi ka përfunduar me *vlerësimin e detyrave të portofolit dhe të projektit ose të një faze të tij*, notat e portofolit i vendos në regjistër.
- Mësuesi duhet të ruajë portofolin e nxënësit deri në përfundim të vitit shkollor.

Vlerësimi i të nxënit (testi/detyra përmbledhëse)

Vlerësimi i të nxënit ndryshe quhet vlerësim përmbledhës. Përdoret për të mbledhur prova dhe të dhëna që tregojnë nëse mësimdhënia ka realizuar qëllimin e saj. Ky është një vlerësim formal dhe kryhet edhe për efekt raportimi.

Si dhe kur realizohet testi/detyra përmbledhëse?

- Në pjesën e fundit të periudhës kryhet *vlerësimi me test ose me detyrë përmbledhëse*, që ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni për periudhën përkatëse.
- Mësuesi ka lirinë të përcaktojë vetë nëse do të zhvillojë test apo detyrë përmbledhëse sipas specifikave të lëndës.
- Testi/detyra përmbledhëse planifikohet nga mësuesi. kur përmyllet një grup rezultatesh të të nxënit dhe mësuesi është *i lirë ta vendosë vetë se kur do ta zhvillojë atë*.
- Testi/detyra përmbledhëse është 45 minuta.
- Drejtoria e shkollës menaxhon organizimin e testeve ose detyrave përmbledhëse sipas një grafiku, në mënyrë që të mos ngarkohet nxënësi në fund të periudhës.
- Testi/detyra përmbledhëse *jo domosdoshmërisht* bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e përcakton vetë kohën se kur do ta zhvillojë atë.
- Në momentin kur mësuesi *vlerëson testet/detyrat përmbledhëse*, i vendos notat në regjistër.
- Mësuesi duhet të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor testet ose detyrat përmbledhëse.

Vlerësimi periodik

Vlerësimi periodik bëhet në përfundim çdo periudhe dhe përmban tri nota:

- *Vlerësimin e vazhdueshëm* – NVv (nota e vlerësimit të vazhduar), e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.
- *Vlerësimin me test përmbledhës* – NTP (nota e testit përmbledhës), e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.
- *Vlerësimin e portofolit lëndor* – NVp (nota e vlerësimit të portofolit), e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.

Vlerësimi përfundimtar

Vlerësimi përfundimtar shënohet në regjistër duke plotësuar kolonat “Vlerësimet vjetore” dhe kolonën e “Nota përfundimtare”.

Vlerësimet vjetore përmbajnë:

- *Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar, që është rezultati tri periudhave.*
- *Notën vjetore të vlerësimit me test ose me detyrë përmbledhëse, që është rezultati tri periudhave.*
- *Notën vjetore të vlerësimit të portofolit që është rezultat i tri periudhave.*

Kur ecuria e nxënësit është e dukshme progresive ose regresive gjatë dy periudhave të fundit, vlerësimi i tij vjetor në secilën nga rubrikat mund të jetë progresiv ose regresiv. Kur ecuria e nxënësit nuk është e qëndrueshme përgjatë tri periudhave, atëherë vlerësimi llogaritet me mesatare. Nota përfundimtare llogaritet me përqindje për secilën nga rubrikat.

Hapat për njehsimin e notës përfundimtare janë:

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NV_V), bazuar në tri notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Përcaktohet nota vjetore e testit përmbledhës (NT_P) bazuar në tri notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NV_P) bazuar në tri notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse
- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh., 8,8 \approx 9).

$$(NV_V \times 0.4) + (NT_P \times 0.4) + (NV_P \times 0.2) = \text{Nota përfundimtare}$$

Përshkrimi i notës përfundimtare vjetore argumenton nivelin e arritjeve të kompetencave të lëndës. Përshkrimi u referohet pikave më të forta që ka nxënësi lidhur me përmbushjen e kompetencave të lëndës.

IV. Modele vlerësimi të nxënësve në disa fusha të nxëni ose lëndë mësimore

Vlerësimi i nxënësve në lëndën “Gjuhë shqipe”

Vlerësimi i nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe ka për synim matjen e kompetencave kycc dhe të lëndës, të paraqitura nëpërmjet rezultateve të të nxënit. Mësuesi, në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, siguron përdorimin e të gjitha llojeve të vlerësimit, të cilat përcaktohen si të domosdoshme për të gjykuar në lidhje me arritjet e nxënësve, në funksion të mbështetjes së të nxënit dhe mësimdhënies.

Nivelet e arritjeve

Arritjet e nxënësve regjistrohen dhe raportohen kundrejt niveleve të arritjes. Mësuesi duhet t'i përdorë nivelet e arritjes, kur merr një vendim për arritjet e nxënësve në lidhje në rezultatet e të nxënësve. Nivelet e arritjes përshkruajnë nivelin në të cilën nxënësi duhet të punojë për të arritur një nivel ose notë të caktuar.

a) Vlerësimi i vazhduar

Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe gjykimet e mësuesit mbi *përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët me shkrim, bisedat letrare, punët në grup, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe debatet në klasë, detyrat e shtëpisë apo të klasës etj.*, përgjatë një periudhe.

Për vlerësimin e vazhduar të arritjes së rezultateve të të nxënësve, mësuesi mban shënime në evidencë për çdo nxënësi. Shënimet në evidencë mund të mbahen me simbole etj., të shoqëruara me komente, të cilat u referohen niveleve të arritjes së kompetencave lëndore. Punët me shkrim (si në shembullin e mëposhtëm) do të vlerësohen me notë.

Për lehtësimin e punës së tij mësuesit i sugjerohet të shkruajë në fund të evidencës një legjendë, e cila shpjegon kuptimin e simboleve të vendosura.

Komentet i referohen niveleve të arritjes së kompetencave lëndore bazuar në dokumentin përkatës të "Niveleve të arritjes" shkallët 3-4 (klasat 6-9).

Shembull 1: Gjuhë shqipe (klasa VI)

Periudha: Prill- qershor

Nr.	Nxënësi / Data	14.04	04.05	13.05	24.05	03.06	Komentet janë: Nivelet e arritjes për njohurinë/konceptin përkatës
1	Elira Bardhi	+-					N2. Tekst jo letrar (tiparet kryesore të biografisë)
			✓				N3. Tekst letrar (interpretimi i poezisë)
				8			Punë me shkrim (tregim i shkurtër)
						+	N3. Bisedë letrare (tregime)
							+

Legjendë: ++ (sh. mirë); + (mirë); +- dhe ✓ (mesatar); -+ dhe ? (nën mesatar); - dobët; - - (sh. dobët). N1- Niveli 1; N2 – Niveli 2; N3 – Niveli 3; N4 – Niveli 4. TN – test i ndërmjetëm

Në përfundim të periudhës tremujore, vlerësimi i vazhduar mbyllet me një notë përmbledhëse (NVv). Nota e vlerësimit të vazhduar në këtë rast gjykohet në bazë të ecurisë (progresit ose regresit) të arritjeve të nxënësit përgjatë periudhës, pra NVv është 8. Në shembullin e mësipërm ecuria e nxënësit është progresive, por mund të jetë edhe regressive.

Ndryshimi kryesor që ka ndodhur në vlerësimin e nxënësit gjatë zbatimit të kurrikulës së re është vlerësimi për të nxënë (vlerësimi i vazhduar). *Fokusi kryesor i vlerësimit për të nxënë (vlerësimit të vazhduar) është që nxënësi të përmirësojë të nxënit e tij, si dhe të motivohet më shumë për të mësuar.* Pra, vlerësimi për të nxënë nuk ka si qëllim kryesor vendosjen e një note, por të evidentojë të nxënësi pikat e forta dhe problematikat dhe ta ndihmojë që t'i përmirësojë ato. Në këto kushte, mësuesi duhet të fokusohet te procesi i të nxënit dhe jo te vendosja e notës.

Si dokumentohet vlerësimi i vazhduar (vlerësimi për të nxënë)?

- Fletorja personale dhe evidenca nënkuptojnë të njëjtin dokument. Pra, mësuesi ka vetëm një dokument për vlerësimin e vazhduar (vlerësimin për të nxënë).
- Mësuesi mban shënime në fletoren e tij personale (apo në evidencë) ecurinë e progresit të nxënësit lidhur me rezultatet e arritjes.
- Fletoren personale (evidencën) mësuesi e formaton në mënyrën më të përshtatshme për të, por duke ruajtur logjikën e vlerësimit për të nxënë. Me fletoren personale (evidencën) mësuesi është i lehtësuar nga ngarkesa ose nga presioni për të vënë nota në regjistër në mënyrë të vazhduar.
- Mësuesi është i lirë t'i mbajë shënimet në fletoren e tij personale (evidencë) duke vendosur simbolet, që ai gjykon si të përshtatshme, të shoqëruara me komente shumë sintetike, të cilat iu referohen niveleve të arritjes së kompetencave lëndore.
- Komenti përmban nivelin e arritjes duke e shënuar me simbolin përkatës (p.sh., N₃ ose N₄), si dhe konceptin/konceptet përkatëse për të cilin është vëzhguar nxënësi.
- Përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, punët individuale, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimi i nxënësit, vlerësimi i nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjet në aktivitete dhe diskutimet në klasë, detyrat e shtëpisë apo të klasës etj., vlerësohen me simbole. Vendosja e notës në mënyrë të vazhduar gjatë vlerësimit për të nxënë nuk ndihmon procesin e të nxënit, motivimin e nxënësve për të nxënë dhe zhvillimin e kompetencave.
- Nota në fletoren personale (evidencë) mund të vendoset vetëm në raste specifike, siç janë testet e ndërmjetme apo punët me shkrim etj.

- Nota e vlerësimit të vazhduar që vendoset në regjistër në faqen “Vlerësimi periodik” duhet të jetë *rezultante progresive (ose regresive) e vlerësimeve që mësuesi ka mbajtur në fletoren e tij personale.*
- Fletorja personale (evidenca) është objekt monitorimi, por nuk duhet dorëzuar në përfundim të periudhës.
- Mësuesi mban përgjegjësi për fletoren personale dhe duhet të argumentojë notën e vlerësimit të vazhduar të vendosur në regjistër.
- Mësuesi duhet të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor fletoren personale (evidencën), teste/detyra të ndërmjetme, punët me shkrim, etj. Këto do t’i shërbejnë për të argumentuar notën e vlerësimit të vazhduar.
- Drejtuesit e shkollave nuk duhet të ngarkojnë mësuesit me detyrimin për të mbajtur dy dokumente për vlerësimin e vazhduar të nxënësve: evidencën e vlerësimit të vazhduar dhe fletoren personale të shënimeve, ato janë e njëjta gjë.
- Gjatë periudhës, mësuesi i lëndës ka përgjegjësi për të informuar nxënësin për ecurinë dhe mundësinë e tij për progres.

b) Vlerësimi me portofol lëndor

Portofoli është koleksionim sistematik i detyrave dhe i punimeve krijuese dhe hulumtuese të kryera nga nxënësi përgjatë periudhës për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohurive, shkathtësive, qëndrimeve). Në lëndën e gjuhës shqipe sugjerohet që përgjatë një periudhe, të përfshihen në portofol rreth 3 (tri) detyra të nxënësit, përfshirë projektin ose një nga fazat e tij. Pra, pjesë e portofolit është edhe projekti kurrikular. Projekti kurrikular mund të jetë i shtrirë vetëm brenda një periudhe, por mund të jetë i shtrirë (nëse është një) edhe përgjatë gjithë vitit. Sido që të jetë shtrirja e projektit ai ka vlerësimin e tij brenda vlerësimit të portofolit. Nëse projekti ka shtrirje përgjatë gjithë vitit, në çdo periudhë vlerësohet si pjesë e portofolit ajo pjesë e projektit që është realizuar. Në rastin kur ka shtrirje brenda një periudhe vlerësohet i gjithë projekti.

Për vlerësimin e portofolit, mësuesi përcakton kritere të qarta dhe ua komunikon nxënësve. Vlerësimi i detyrave të portofolit varet nga pesha që secili mësues i vendos secilës detyrë.

Rubrikat e portofolit mund të grupohen në:

- punë dhe detyra të kryera në klasë dhe jashtë saj;
- projekte individuale ose në grup;
- detyra dhe kontribute të pavarura të nxënësit, të cilat janë dëshmi e talentit, e hulumtimeve praktike, e punëve tematike (me shkrim, audio-vizuale etj.).

Në shembullin më poshtë, mësuesi në bashkëpunim me nxënësit ka përcaktuar detyra për portofolin e periudhës së parë, i cili do të ketë gjithsej 50 pikë. Për vlerësimin e portofolit mësuesi përcakton vetë pikët/peshat për secilën detyrë.

Më poshtë janë dhënë dy shembuj, pikët/peshat e të cilëve shërbejnë thjesht për të ilustruar modelin dhe mund të mos përdoren domosdoshmërisht nga mësuesi.

Shembull 1:

- a) Përshkruani ngjashmëritë dhe dallimet mes jush dhe një personazhi të pëlqyer nga ju. 10 pikë
- b) Projekti “Përgatitja e një reviste për fëmijë” (faza e parë). Përzgjedhja e rubrikave dhe mbledhja e informacionit kryesor. 20 pikë
- c) Gjetja e rasteve të përdorimit të gabuar të shkronjës së madhe në jetën e përditshme, si p.sh.: në meny, në tabela të ndryshme, në televizion, në libra etj. 20 pikë

Vlerësimi me pikë

Detyra	Detyra 1	Detyra 2	Detyra 3	Portofoli
Nota	8 pikë	14 pikë	14 pikë	36 pikë

Sipas tabelës së vlerësimit me notë (si në rastin e vlerësimit të testeve), vlerësimi i këtij portofoli është nota 8 (tetë).

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-12	13- 19	20-26	27 - 32	33-38	39-44	45-50

Shembull 2

- a) Një përmbledhje të shkurtër të një libri që keni lexuar gjatë pushimeve. 10 pikë
- b) Projekti “Udhëtoj drejt vendlindjes”. Prezantimi individual i projektit. 20 pikë
- c) Ktheni një përrallë të shkurtër në gjuhën standarde. 5 pikë

Vlerësimi me pikë

Detyra	Detyra 1	Detyra 2	Detyra 3	Portofoli
Nota	9 pikë	19 pikë	4 pikë	32 pikë

Sipas tabelës së vlerësimit me notë (si në rastin e vlerësimit të testeve), vlerësimi i këtij portofoli është nota 10 (dhjetë).

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-8	9-13	14-18	19-23	24-27	28- 31	32-35

d) *Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse*

Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni. Mësuesi përzgjedh të zhvillojë test ose detyrë përmbledhëse, në varësi të veçorive të lëndës. Testi përmbledhës është test që përmban vetëm

Hartimi i testit

Një nga format e vlerësimit të arritjeve të nxënësve në shkollë nga stafi drejtues është testi dhe Në raport me format e tjera të vlerësimit, kjo formë është me objektive dhe të krijon mundësinë:

- të përcaktosh nivelin e arritjeve të nxënësve për një periudhë të caktuar;
- të dallosh konceptet në të cilat nxënësit shfaqin dobësi;
- të monitorosh progresin ose jo, të nxënësve në raport me vlerësimin paraardhës;

Hapat për hartimin e një testi janë:

- *Përcaktimi i rezultateve të të nxënit të kompetencave dhe i koncepteve që do të vlerësohen (% e pikëve që do të zënë në test, e cila është në koherencë me % që kanë në programin e gjuhës shqipe).*
- Përcaktimi i peshës së niveleve që do të zbatohet në test. Niveli i dytë i arritjes së kompetencave (*rekomandohet 40%*) përfshin pyetje ku kërkohet që nxënësi të zbatojë një procedurë rutinë, mjaft të ushtruar në klasë. Niveli i tretë i arritjes së kompetencave (*rekomandohet 40%*) përfshin pyetje ku nxënësit nuk i mjafton të kujtojnë procedura rutinë, as të imitojnë zgjidhje standarde. Ai duhet të ndjehet para një situatë më komplekse, të cilën mund ta zgjidhë duke kombinuar njohuritë që disponon. Niveli i katërt i arritjes së kompetencave (*rekomandohet 20%*) përfshin pyetje ku nxënësi gjykon, zgjidh, jep mendim, vlerëson, harton etj., duke vënë në dispozicion njohuritë e tij.
- Ndërtimi i tabelës së specifikimeve (blueprintit)

Kompetencat	Përqindja = Pikët	Rezultatet e të nxënit	Niveli II i arritjes së kompetencave	Niveli III i arritjes së kompetencave	Niveli IV i arritjes së kompetencave
.....
Pikët total të testit	100% = ... pikë		35% - 40% = ... pikë	35% - 40% = ... pikë	20% - 25% = ... pikë

--	--	--	--	--	--

- Hartimi i pyetjeve të testit.
- Përcaktimi i skemës së vlerësimit (*bazuar në shpërndarjen normale*). Sistemi i pikëzimit që përdoret më shumë është ai që quhet analitik. Dy nga elementet bazë të këtij sistemi janë:
 - caktimi i pikëve për konceptet që testohen;
 - skema e pikëzimit (*ku jepen kriteret e shpërndarjes së pikëve që janë përcaktuar për konceptet që do të testohen, duke pasur parasysh përgjigjen e saktë që duhet të jepet për këtë çështje*).

Në konvertimin e pikëve me nota, kufiri i poshtëm rekomandohet 25% e totalit të pikëve. Më pas caktohen intervalet e pikëve nga nota 4 – 10, të cilat janë si më poshtë

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Përqindja e pikëve	<25%	25-38%	39-51%	52-64%	65-77%	78-90%	91-100%

Pyetjet dhe llojet e tyre

Pyetjet në një test janë objektive, gjysmë objektive dhe subjektive. Pyetjet janë objektive, kur për to vlerësues të ndryshëm arrijnë në të njëjtin vlerësim, duke u bazuar në një çelës përgjigjesh të sakta. Pyetjet janë gjysmë objektive, kur përgjigja mund të jepet në formën e një fjalie të vetme ose të disa fjalive. Ndërsa pyetjet subjektive kanë këto karakteristika:

- përgjigje të lira, të cilat mbështeten mbi një material;
- nuk ka kufizime në lidhje me gjatësinë ose stilin e përgjigjes (megjithëse kjo mund të përcaktohet në një farë mase);
- nuk kërkohet ndonjë strukturim i ngurtë i përgjigjes, megjithëse pyetja vetë duhet të jetë specifike dhe pa shumëkuptimësi.

Llojet e pyetjeve objektive

Pyetjet me përgjigje alternative (pyetje me 2 variante zgjedhjeje) marrin përgjigjet:

- po/jo;
- e vërtetë - e gabuar.

Shembull:

Kjo pjesë është përrallë.

V_____

G_____

Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë (me alternativa)

Këto pyetje japin një trung (rrënja) në formën e një pyetjeje apo të fjalie të paplotë dhe disa alternativa (tre ose katër), një prej të cilave është e vërtetë dhe pjesa tjetër janë alternativa hutuese. Këto pyetje janë të vlefshme për vlerësimin e njohurive, krahasime, zbatime të thjeshta, njohje e zbatim rregullash të thjeshta, formula e koncepte etj. Struktura e tyre është: trungu (rrënja), alternativat (përgjigjja e saktë dhe ç'orientuesit).

- Rekomandohen katër alternativa. Përdorimi i shumë alternativave do të ishte i pakuptimtë.
- Renditni alternativat sipas rendit alfabetik.
- *Trungu (rrënja) duhet të jetë një pyetje apo një pohim?* Të dyja strukturat janë të pranueshme. Disa hartues preferojnë të zgjedhin një strukturë dhe ta ruajnë atë vazhdimisht, por disa të tjerë i përdorin të dyja strukturat.
- Sigurohuni që trungu i pyetjes shpreh në mënyrë të plotë një çështje, në mënyrë që nxënësit të dinë mirë të bëjnë atë çfarë shpresohet prej tyre, para se të lexojnë alternativat.
- Shmangni përdorimin e fjalëve mohuese. Nxënësit në përgjithësi nuk e shohin “NUK” në një trung pyetjeje. Nëse ajo duhet përdorur patjetër është mirë ta dalloni duke e theksuar (*bold*) ose duke e kapitalizuar (NUK).
- Sigurohuni që të gjitha përgjigjet janë afërsisht në të njëjtën gjatësi, gramatikë apo vështirësi konceptimi.
- MOS jepni alternativa që janë pjesërisht të sakta ose i mbivendosen përgjigjes së saktë.
- MOS përdorni alternativat ”*të gjitha më sipër*” apo “*A dhe B*”, të cilat e bëjnë pyetjen të vështirë në mënyrë të panevojshme për nxënësit.
- Përdorni udhëzime me gojë për ata që kanë vështirësi leximi.
- Përdorni shkronja të mëdha shtypi për të shënuar alternativat.

Shembull:

Cila nga fjalitë e mëposhtme tregon më së miri atë që ndodh mes elefantit dhe krokodilit në këtë ngjarje?

1 pikë

- A) Ata janë duke konkurruar me njëri-tjetrin.
- B) Ata kanë xhelozë për njëri-tjetrin.
- C) Ata janë mirënjohës ndaj njëri-tjetrit.
- D) Ata janë dashamirës për njëri-tjetrin.

a) Pyetjet me plotësim

Këto janë pyetje në formën e një fjalie që i mungon një pjesë, e cila mund të jetë fjalë a togfjalësh. Mund të jetë edhe një pjesë teksti, me pjesë të paplotësuara. Vendosja e pjesëve të munguara i jep

kuptimin e duhur fjalisë apo tekstit kuptimin e plotë. Ndërtoni fjalinë në mënyrë që përgjigja e vërtetë të jetë e shkurtër dhe vetëm një. Pjesën që mungon është më mirë ta vendosim në fund të fjalisë se në fillim të saj.

Shembull: Në muret e kalasë së Shkodrës u muros _____

Pyetjet me kombinime (me çiftime)

Në këto pyetje:

- zgjidhen çifte fjalësh që kombinohen nga dy lista të dhëna;
- nxënësi duhet të bëjë lidhjen korrekte mes tyre;
- variantet e dhëna në një anë duhet të jenë më të shumta se në anën tjetër.

Pyetjet gjysmë objektive

Këto pyetje kërkojnë përgjigjen e një pyetjeje direkt ose plotësim të një fjalie të paplotë. P.sh.:

Fabula është _____

Pyetjet subjektive

a) *Eseja e strukturuar:*

- ka për qëllim kufizimin e përgjigjes;
- forma e përgjigjes kufizohet nga mënyra sesi ndërtohet pyetja. P.sh.: *Përshkruaj në jo më shumë se 100 fjalë personazhin e Rinës në rrëfenjën “Rinë Katerinëza” të Kutelit ”*

b) *Eseja e pastrukturuar* i jep mundësi nxënësit të demonstrojë:

- aftësi në përdorimin e gjuhës;
- fuqinë e analizës;
- aftësi në përzgjedhjen e përgjigjes;
- aftësi argumentuese;
- etj.

Kërkesa e esesë duhet të jetë sa më e qartë. Për këtë ka rëndësi folja e përdorur: përshkruaj, shpjego, vlerëso... etj.

Pikët dhe kriteret e pikëzimit

Pikët janë tregues të nivelit të arritjeve. Qëllimi i vendosjes së tyre është marrja dhe dhënia e informacionit në lidhje me arritjet e nxënësve. Sistemi analitik është më i përshtatshmi për pikëzim. Ai bazohet në vendosjen e pikëve për elemente të caktuara të përgjigjes. Sistemi analitik i pikëzimit ka 2 kërkesa: caktimi i pikëve për çdo pyetje të testit dhe hartimi i skemës së pikëzimit.

Vlerësimi me pikë i pyetjeve objektive dhe gjysmë objektive

- Pyetjet po/jo; e vërtetë/ e gabuar vlerësohen me 1 pikë.

- Pyetjet me çiftim; për çdo çiftim të saktë nxënësi merr 1 pikë
- Pyetjet me plotësim: për çdo plotësim nxënësi merr 1 pikë.
- Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë: për çdo përgjigje të saktë nxënësi merr 1 pikë.
- Pyetjet me përgjigje të shkurtër: për çdo kërkesë nxënësi merr 1 pikë.

P.sh.: për pyetjen me 2 pikë “Gjeni figurën letrare dhe tregoni funksionin e saj”, nxënësi:

- vlerësohet me 0 pikë nëse nuk jep asnjë përgjigje;
- vlerësohet me 1 pikë, nëse gjen vetëm figurën letrare;
- vlerësohet me 2 pikë nëse gjen figurën letrare dhe funksionin e saj.

c) *Vlerësimi periodik*

Vlerësimi periodik bëhet në përfundim çdo periudhe dhe përmban tri nota:

- *Nota e vlerësimit të vazhdueshëm (NVv)*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.
- *Nota e vlerësimit me test ose me detyrë përmbledhëse (NTp)*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.
- *Nota e vlerësimit të portofolit lëndor (NVp)*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.
-

d) *Vlerësimi përfundimtar*

Vlerësimi përfundimtar shënohet në regjistër duke plotësuar kolonat “Vlerësimi vjetor” dhe në kolonën “Nota përfundimtare”.

Vlerësimet vjetore përmbajnë:

- *notën vjetore të vlerësimit të vazhduar* që është rezultat i tri periudhave;
- *notën vjetore të vlerësimit me test ose detyrë përmbledhëse* që është rezultat i tri periudhave;
- *notën vjetore të vlerësimit të dosjes së nxënësit* që është rezultat i tri periudhave.

Në rast kur ecuria e nxënësit është e dukshme progresive ose regressive gjatë dy periudhave të fundit, vlerësimi i tij vjetor në secilën nga rubrikat mund të jetë progresiv ose regresiv. Në rast se ecuria e tij nuk është e qëndrueshme përgjatë tri periudhave, atëherë vlerësimi llogaritet me mesatare.

Nota përfundimtare llogaritet me përqindje për secilën nga rubrikat

Tabela: Peshat në përqindje të llojeve të vlerësimit

Lloji i vlerësimit	Pesha në përqindje
Vlerësimi i vazhdueshëm	40%
Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse	40%

Vlerësimi i portofolit të nxënësit	20%
------------------------------------	-----

Hapat për njehsimin e notës përfundimtare janë:

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NV_V), bazuar në tri notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Përcaktohet nota vjetore e testit/detyrës përmbledhëse (NT_P) bazuar në tri notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NV_P) bazuar në tri notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh., 8,8 ≈ 9).

$$(NV_V \times 0.4) + (NT_P \times 0.4) + (NV_P \times 0.2) = \text{Nota përfundimtare}$$

Përshkrimi i notës përfundimtare vjetore argumenton nivelin e arritjeve të kompetencave të fushës/lëndës. Përshkrimi i referohet pikave më të forta që ka nxënësi lidhur me përbushjen e kompetencave të lëndës.

Shembull 1: Gjuhë shqipe, klasa VII

Tremujori I			Tremujori II			Tremujori III			Notat vjetore			Nota përfundimtare
NV V	NT _P	NV P	NV V	NT _P	NV P	NV V	NT _P	NV P	NV V	NT _P	NV P	
7	6	7	8	7	8	8	7	9	8	7	8	8

$$(8 \times 0.4) + (7 \times 0.4) + (8 \times 0.2) = 7.6$$

Nota përfundimtare 8

Nota përfundimtare	Përshkrimi i vlerësimit
8	Arbri... kupton, interpreton, analizon mirë tekste të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe jep disa gjykime rreth tyre. Ai shkruan duke u

përqendruar në temën që do të trajtojë dhe lidh mirë fjalitë në paragraf e paragrafët mes tyre. Ai përdor mirë gjuhën standarde dhe zbaton rregullat gramatikore e drejtshkrimore.
--

Vlerësimi i nxënësve në lëndën “Matematikë”

a) Vlerësimi i vazhduar (për të nxënë)

- Vlerësimi për të nxënë shpesh quhet vlerësim formativ dhe është vlerësim që mbledh të dhëna dhe dëshmi rreth të nxënësve gjatë procesit të të mësuarit. Kjo mundëson të shihni se ku kanë nxënësit probleme dhe për të dhënë reagime të menjëhershme të cilat do t'i ndihmojnë nxënësit tuaj të mësojnë më mirë. Gjithashtu, vlerësimi për të nxënë ju ndihmon të planifikoni punën tuaj për të zhvilluar mësimin në mënyrë më efektive. *Shpesh ky vlerësim është informal dhe nxënësit mund të mbajnë shënime vetë mbi progresin e tyre. Një shembull është një kuiz i shpejtë për të parë nëse nxënësit i kujtojnë pikat e rëndësishme të mësimin të kaluar.*
- Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe gjykimet e mësuesit mbi *përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, punët individuale, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës etj.*, përgjatë një periudhe.
- Për vlerësimin e vazhduar të arritjes së rezultateve të të nxënës, mësuesi mban shënime në evidencë (fletore) për çdo nxënë. Shënimet në evidencë mësuesi i përcakton sipas mënyrës së tij kryesisht me simbole të shoqëruara me komente, të cilat i referohen niveleve të arritjes së kompetencave matematikore, por edhe me notë në raste specifike siç janë testet e ndërmjetme apo kuize të shkurtra.
- Komenti përmban nivelin e arritjes duke e shënuar me simbolin përkatës (**p.sh., N₃ ose N₄**), si dhe konceptin përkatës për të cilin është vëzhguar nxënësi, psh *N₃ Teorema e Sin ose N₂Ekuac i fuq se I ose N₄ Zmadhimi.*
- Nxënësi ka 9 nota në regjistër deri në përfundim të vitit shkollor, të mjaftueshme për të nxerrë notën përfundimtare.
 - **Shembul** : Matematikë (klasa VII)
 - Periudha:shtator - dhjetor

Nr.	Nxënësi / Data	30.09	14.10	31.10	9.11	9.12	Komentet janë: Nivelet e arritjes për njohurinë/konceptin përkatës
	Denisa	+-					N3. SHVP

1	Kroi		✓			N3. Drejtëza paralele, pingule, prerëse
				9		TN
					+	N4. Katrori i numrave deri në 20
					++	Kuiz i shkurtër

Legjendë: ++ (sh. mirë); + (mirë); +- dhe ✓ (mesatar); -+ dhe ? (nën mesatar); - dobët; - - (sh. dobët). N1- Niveli 1; N2 – Niveli 2; N3 – Niveli 3; N4 – Niveli 4. TN – test i ndërmjetëm Në përfundim të periudhës tremujore, vlerësimi i vazhduar mbyllet me një notë përmbledhëse (NVv).

Nota e vlerësimit të vazhduar në këtë rast gjykohet në bazë të ecurisë (progresit ose regresit) të arritjeve të nxënësit përgjatë periudhës, pra **NVv është 9**. Në shembullin e mësipërm ecuria e nxënësit është progresive, por mund të jetë edhe regressive.

- Evidenca (fletorja e shënimeve) menaxhohet nga vetë mësuesit. Mësuesi është i lirë të ndryshojë formatin e evidencës duke ruajtur llogjikën e vlerësimit për të nxënë dhe të përcaktojë vet se si do të mbajë shënimet për ecurinë e nxënësit.

b) Vlerësimi i të nxënit (testi përmbledhës)

Vlerësimi i të nxënit quhet shpesh vlerësim përmbledhës. Përdoret për të mbledhur prova dhe të dhëna që tregojnë nëse mësimdhënia ka realizuar qëllimin e saj. Zakonisht planifikohet në fund të një njësie apo të një periudhe të caktuar. Ky është një vlerësim formal dhe kryhet edhe për efekt raportimi. Në përfundim të periudhës (kur e vendos mësuesi) kryhet *vlerësimi me test përmbledhës*, e cila ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni për periudhën përkatëse. Testi ose detyra përmbledhëse planifikohet nga mësuesi kur përmbillet një grup rezultatesh të të nxënit dhe mësuesi është i lirë ta vendosë vetë se kur do ta zhvillojë atë.

- Testi përmbledhës është 45 min.
- Drejtoria e shkollës menaxhon organizimin e testeve sipas një grafiku në mënyrë që të mos ngarkohet nxënësi në fund të periudhës. (Testi jodomosdoshmërisht bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e gjykon vetë kohën se kur do të zhvillojë testin përmbledhës).

c) Vlerësimi i portofolit lëndor të nxënësit

Portofoli është koleksionim sistematik i detyrave dhe punimeve të kryera nga nxënësi për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohurive, shkathtësive, qëndrimeve).

- Në fillim të periudhës, mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, përcaktojnë detyrat që do të përfshijnë në portofol përgjatë periudhës, në varësi të specifikave të lëndës.
- Mësuesi në fillim të periudhës përcakton dhe ju prezanton nxënësve peshat/pikët për vlerësimin e secilës detyrë.
- Mësuesi udhëzon nxënësit për krijimin dhe zhvillimin e portofolit dhe bashkëpunon me ta rreth përmbajtjes së tij.
- Mësuesi monitoron përgjatë gjithë periudhës zhvillimin e detyrave të portofolit.

Struktura e portofolit:

Portofoli i nxënësit duhet të përmbajë detyra/punë hulumtuese/projekte të nxënësve që tregojnë kompetencat apo rezultatet e të nxënësit për t'u arritur në një lëndë. Detyrat e portofolit nuk janë pjesë e vlerësimit të vazhduar të nxënësit.

Për një periudhë, portofoli duhet të përmbajë dy- tri detyra, përfshirë projektin kurrikular.

📁 Projekti ose një fazë e tij është pjesë e detyruar e portofolit për çdo periudhë.

📁 1 -2 detyra krijuese, zbatuese, hulumtuese etj.

Detyrat e portofolit duhet të jenë me të njëjtën temë për çdo nxënë. Detyrat e portofolit mund të jenë punime të kryera në klasë dhe/ose jashtë saj, dëshmi e kontributeve dhe talentit të nxënësit, me karakter hulumtues dhe krijues të tilla si:

- punë praktike individuale,
- produkte të krijuara nga nxënësit,
- punime audio-vizuale,
- aktivitetet në grup ose individual;
- projekte individuale ose në grup;
- etj.

Kujdes! Detyrat NUK duhet të jenë domosdoshmërisht të punuara me kompjuter.

Vlerësimi i portofolit

Vlerësimi i portofolit përcaktohet nga pesha/pikët që secili mësues i vendos çdo detyrë të portofolit. Mësuesi i vendos peshat/pikët në varësi të llojit të detyrës. Vlerësimi i secilës detyrë të portofolit bëhet mbi bazë të kriterëve që mësuesi vendos bazuar në llojin e detyrës së dhënë. Detyrat e portofolit vlerësohen në përgjithësi kur ato dorëzohen dhe nuk lihen për në fund kur vlerësohet i gjithë portofoli.

Vlerësimi i portofolit mund të planifikohet si orë e veçantë në planifikimin e periudhave ose mund të realizohet përgjatë tre – katër orëve të fundit të periudhës. Në këtë rast mësuesi përcakton një grafik të nxënësve të cilëve do t'u vlerësohet portofoli. *Mësuesi duhet të kujdeset që të mos mbingarkojë*

nxënësin me detyra në përfundim të periudhës. Ai, gjithashtu, mund të rakordojë punën me mësuesit e lëndëve të tjera për të menaxhuar ngarkesën e nxënësve.

Shembull portofoli në lëndën e matematikës

Në lëndën e matematikës, mësuesi mund të planifikojë të paktën 3 detyra për portofolin lëndor (përfshirë edhe projektin kurrikular). Në shembullin më poshtë, mësuesi, në bashkëpunim me nxënësit, ka përcaktuar 3 detyra për portofolin e periudhës së dytë, i cili do të ketë gjithsej 30 pikë. Për vlerësimin e portofolit mësuesi *përcakton vetë* pikët për secilën detyrë. (Më poshtë është dhënë thjesht një shembull, pikët e të cilit shërbejnë për të ilustruar modelin dhe mund të mos përdoren domosdoshmërisht nga mësuesi).

- ☞ Hulumtim mbi mozaikët si vepra arti në Shqipëri. Krijoni vetë një mozaikë duke shpjeguar se çfarë figurash keni përdorur (me kompjuter ose me vizatim). Mund të gjeni shumën e këndeve, shumën e brinjëve etj? 10 pikë
- ☞ Njësitë e përbëra. Ku përdoren ato. Shqyrtoni një shembull të përdorimit të njësisë së përbërë. Çfarë mat ajo? Si mund të këmbehen në një njësi tjetër të përbërë? etj. 5 pikë
- ☞ Projekti (faza e dytë) Diskutimi i materialeve të siguruar nga nxënësit dhe përpunimi i tyre individualisht dhenë grup. 15 pikë

Mësuesi përcakton tabelën e pikëve (si rasti i testeve).

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	>7	8-11	12-15	16 - 19	20-23	24-27	28-30

Në shembullin e mësipërm nxënësi vlerësohet nga mësuesi si më poshtë:

Detyra	Detyra 1	Detyra 2	Detyra 3	Portofoli
Nota	8 pikë	4 pikë	12 pikë	24 pikë

Vlerësimi me pikë i këtij për portofolin e këtij nxënësi është nota 9 (nëntë)

Kriteret dhe reflektimi për detyra të ndryshme në lëndën e matematikës

Kriteret për kryerjen e detyrave

Mësuesi duhet të përcaktojë kriteret vlerësimi për çdo detyrë dhe të sigurojë udhëzime të qarta për nxënësit se si do të jetë detyra e përfunduar dhe si do të zbatohen kriteret. Kur vendosni një detyrë sigurohuni që:

- kërkesat e detyrës janë bërë sa më qartë të jetë e mundur për studentin;
- kriteret e vlerësimit dhe nivelet e arritjes t'i ofrohen çdo nxënësi në mënyrë që ata të dinë se çfarë duhet të bëjnë;

- çdo burim ose material i përdorur të jetë i qartë dhe i përshtatshëm për detyrën;
- arritjet e nxënësit maten për më shumë se një rezultat të nxëni;
- udhëzimet të jenë të qarta dhe koncize;
- niveli i gjuhës të jetë i përshtatshëm për vlerësimin;
- detyra nuk përmban gjini, kulturë ose ndonjë paragjykim tjetër;
- koha e lejuar është e mjaftueshme për kryerjen e detyrës.

Reflektimi i mësuesit

Kur vlerësoni detyrën, mos harroni se reflektimet tuaja do të ndihmojnë nxënësit të kuptojë pse ai mori atë rezultat dhe si mund të bëhet më mirë herën tjetër.

Reagimi duhet të jetë:

- ✓ konstruktiv në mënyrë që nxënësit të ndihen të inkurajuar dhe të motivuar për t'u përmirësuar;
- ✓ në kohë, në mënyrë që nxënësit ta përdorë atë për të mësuar në vazhdim;
- ✓ i menjëhershëm në mënyrë që nxënësi të mund të mbajë mend atë bëri dhe të reflektojë në kohë;
- ✓ i fokusuar në arritje dhe përpjekje, jo te personi - puna duhet të vlerësohet, jo nxënësi;
- ✓ specifike për rezultatet e të nxënit në mënyrë që vlerësimi të jetë i qartë lidhur me të mësuarin.

Përgjigjet tuaja mund të jenë:

- ❖ informale ose indirekte - të tilla si reagimet verbale në klasë (me tërë klasën), ose në mënyrë individuale me vetë nxënësin.
- ❖ formale ose të drejtpërdrejta - të tilla si listat e kontrollit ose komentet për nxënësin në mënyrë individuale në formë të shkruar ose verbale;
- ❖ formative—të dhëna gjatë mësimit me qëllim ndihmës për nxënësin që të di se si të përmirësohet;
- ❖ përmbledhëse – të dhëna në fund të periudhës (ose të kapitullit) me qëllim informimin e nxënësve për çfarë kanë arritur.

Testet e arritjeve

Një test është një vlerësim formal, përmbledhës, i strukturuar i arritjeve të nxënësve dhe i progresit të nxënësit. Testet janë një aspekt i rëndësishëm i procesit të mësimit - nxënies nëse ata janë të integruar në “rutinën” e klasës dhe nuk trajtohen thjesht si një strategji “përmbledhëse”. Ata i lejojnë nxënësve të monitorojnë progresin e tyre dhe ofron informacion të vlefshëm për mësuesin në planifikimin e mëtejshëm të procesit të mësimit - nxënies. Testet ndihmojnë në nxënien e nxënësve nëse ato janë të lidhura qartë me mësimin dhe rezultatet e të nxënit. Dëshmitë tregojnë se teste të shkurtra janë më efektive për progresin e nxënësit

se sa një test i gjatë. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që testet të korrigojnë dhe nxënësve t'u jepet përshtypja për performancën e tyre. Testet e hartuara në klasë zbulojnë rreth njohurive të nxënësve për përmbajtjen dhe për zhvillimin e të menduarit. Përgjithësisht pyetjet e hapura japin informacion më të detajuar në lidhje me aftësitë e nxënësve sesa një pyetje në të cilën ka vetëm një përgjigje.

Parimet e hartimit të testeve nga mësuesi

Testet lejojnë shumëllojshmëri mënyrash të demonstrimit të aftësive të nxënësve. Prandaj:

- ✘ nxënësit duhet të kuptojnë qëllimin dhe vlerën e testit;
- ✘ testi duhet të masë arritjen e rezultateve të të nxënësve për një kapitull ose periudhë të caktuar;
- ✘ duhen dhënë udhëzime të qarta për secilën pjesë të testit;
- ✘ pyetjet duhet të ndryshojnë nga më e thjeshta te ajo më komplekse;
- ✘ pikët duhet të jepen për çdo pyetje apo rubrikë të testit;
- ✘ pyetjet duhet të jenë të llojeve të ndryshme (po/jo, e saktë/e gabuar, me zgjedhje të shumëfishtë, çiftim i elementeve, plotësim i vendeve bosh, zëvendësim i elementeve; përgjigje e zgjeruar, përgjigje e shkurtër etj.,)

Testet duhet:

- ❖ të jenë të lehtë për t'u lexuar dhe të ketë hapësirë ndërmjet pyetjeve për të lehtësuar leximin dhe shkrimin;
- ❖ të përfshijnë një sërë rezultatesh të nxënësve;
- ❖ të mund të kryhen nga nxënësit me nevoja të veçanta;
- ❖ i krijojnë mundësi nxënësve të zgjedhin kërkesat e ushtrimeve në mënyrë të pavarur nga njëra – tjetra;
- ❖ të kenë nivele të ndryshme të pyetjeve për të përfshirë mbledhjen, përpunimin dhe zbatimin e informacioneve;
- ❖ të llogariten me kohë të mjaftueshme për të përfunduar të gjithë nxënësit;
- ❖ të mos ngatërrohen me minitestet, të cilat masin rendimentin e orës së mësimit dhe kanë vetëm një kërkesë.

Gjatë ndërtimit të testeve të arritjes për një grup njohurish të lëndës së matematikës mësuesi duhet të ketë në konsideratë:

- ❖ Numri i pyetjeve në teste varet nga ajo çfarë do të testohet. Ky numër është i ndryshëm kur synohet testimi i përvetësimit të një koncepti, i përvetësimit të një mësimi, i përvetësimit të një kapitulli, i përvetësimit të lëndës së një periudhe, i përvetësimit vjetor të lëndës etj.

- ❖ Është mirë që testet të hartohen me pyetje të llojeve të ndryshme; në matematikë nuk rekomandohet përdorimi i pyetjeve ese, por i pyetjeve të strukturuar, me alternativa, i pyetjeve me zgjidhje të shkurtër.
- ❖ Pyetjet në test është mirë të radhiten sipas shkallës së vështirësisë së tyre.
- ❖ Numri i pyetjeve të testit varet edhe nga koha në dispozicion, kjo kohë mesatarisht duhet të jetë 45 minuta.
- ❖ Gjatë hartimit të një testi është shumë e rëndësishme vlefshmëria e pyetjeve të tij (d.m. th. garantimi i asaj që testi në tërësi duhet të vlerësojë ato koncepte, njohuri, aftësi e shprehje që ne i kemi vënë vetes si qëllim të kontrollojmë).

Hartimi i testit

Hartimi i një testi të plotë ka ngjashmëri me ndërtimin e një godine të re. Në fillim ndërtohet karkasa e testit dhe më pas bëhet mbushja e saj. Projekti më i thjeshtë i një testi paraqitet me anën e një table, rreshtat e së cilës evidentojnë çështjet mësimore që do të testohen dhe peshat e tyre, ndërsa shtyllat nivelet e arritjes. Prandaj:

- 1) **hapi i parë** do të jetë përcaktimi i listës së koncepteve që do të testohen me peshën përkatëse (% e pikëve që do të zënë secili koncept kryesor në test) si dhe rezultatet e të nxënit sipas kompetencave matematikore.
- 2) **hapi i dytë** është përcaktimi i peshës së niveleve që do të zbatohet në test. Niveli i dytë i arritjes së kompetencave (rekomandohet 40%) përfshin pyetje ku kërkohet që nxënësi të zbatojë një procedurë rutinë, mjaft të ushtruar në klasë. Niveli i tretë i arritjes së kompetencave (rekomandohet 40%) përfshin pyetje, ku nxënësit nuk i mjafton të kujtojnë procedura rutinë, as të imitojnë zgjidhje standarde. Ai duhet të ndjehet para një situatë më komplekse, të cilën, sidoqoftë mund ta zgjidhë duke kombinuar njohuritë që zotëron. Niveli i katërt i arritjes së kompetencave (rekomandohet 20%) përfshin pyetje ku nxënësi gjykon, zgjidh, jep mendim, vlerëson, harton duke vënë në dispozicion njohuritë e tij.
- 3) **hapi i tretë** është ndërtimi i tabelës së specifikimit (blueprint).

Konceptet	Përqindja = Pikët	Rezultatet e të nxënit	Niveli II i arritjes së kompetencave	Niveli III i arritjes së kompetencave	Niveli IV i arritjes së kompetencave
.....

Pikët total të testit	100% = ... pikë		40%= ... pikë Ose 35%	40% = ... pikë Ose 40%	20% = ... pikë Ose 25%

4) **hapi 4** është hartimi i pyetjeve të testit.

5) **hapi 5** është përcaktimi i skemës së vlerësimit (bazuar në shpërndarjen normale). Sistemi i pikëzimit që përdoret më shumë është ai që quhet analitik. Dynga elementet bazë të këtij sistemi janë:

- caktimi i pikëve për konceptet që testohet;
- skema e pikëzimit (ku jepen kriteret e shpërndarjes së pikëve që janë akorduar për konceptet që do të testohet, duke patur parasysh për bazë përgjigjen e saktë që duhet të jepet për këtë çështje).

Në konvertimin e pikëve me nota, kufiri i poshtëm rekomandohet 25% e totalit të pikëve. Më pas caktohen intervalet e pikëve nga nota 4 – 10.

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Përqindja e pikëve	<25%	25-38%	39-51%	52-64%	65-77%	78-90%	91-100%

Llojet e pyetjeve që hartohen në teste

Llojet e pyetjeve që mund të përdoren në teste mund të paraqiten si më poshtë:

a) Pyetje me alternativa (me zgjedhje të shumëfishtë).

- Një pyetje me zgjedhje të shumëfishtë përbëhet nga dy pjesë: nga trungu dhe përgjigjet alternative ndër të cilat dallohet përgjigja e vetme e saktë.
- Alternativat duhet të vendosen vertikalisht pas përmbajtjes së pyetjes, në përputhje me rendin alfabetik.
- Nuk duhet të përdoren alternativa që përplasen me njëra - tjetrën.
- Pyetjet ndërtohen në përgjithësi me 4 alternativa.
- Alternativat duhet të kenë gjatësi të njëjtë.
- Alternativat duhet të jenë homogjene dhe t'í referohen të njëjtës kategori.
- Në alternativa nuk duhet të ketë mbivendosje të dhënash apo intervalelesh kohore.

- Vetëm një alternativë është e saktë.
- Pyetja me alternativë vlerësohet me një pikë.
- Në përgjithësi rekomandohet të mos përdoren si alternativa shprehjet “*asnjë nga të mësipërmet*”, ose “*të gjitha të mësipërmet*”.
- Pyetjet me alternativa shmangin në shkallë të lartë subjektivitetin në pikëzim.

Shembull: Mosha e djalit x është shtatë herë më e vogël se mosha e babait y . Cili nga relacionet e mëposhtëm i përgjigjet kësaj varësie? 1 pikë

- A) $x < 7y$
- B) $y < 7x$
- C) $x = 7y$
- D) $y = 7x$

b) Pyetjet “Po/Jo” ose “e vërtetë/ e gabuar”

Përgjigja e saktë për këto lloj pyetjesh vlerësohet me një pikë.

Shembull: Një ashensor mund të mbajë deri në 450 kg. A mund të rrinë në këtë ashensor 8 vetë që e kanë “mesoren” 60 kg? Po ose Jo

c) Pyetjet me çiftim

Për çdo çiftim të saktë jepet një pikë, pra nëse ushtrimi ka 4 kombinime nga të dy kolonat, nxënësi do të marrë 4 pikë, nga 1 për çdo kombinim të saktë.

Shembull: Çiftoni pohimin me shprehjen shkronjore të saktë.

Pohimi	Shprehje
Shumën e dyfishit të x -it me 3 pjesëtoje me 2	$\frac{3x}{5}$
Trefishin e x -it pjesëtoje me 5	$3x \cdot 5$
Ndryshesën e dyfishit të x -it me 3 pjesëtoje me 2	$\frac{2x+3}{2}$
Prodhimi i trefishit të x -it me 5	$\frac{2x-3}{5}$

d) Pyetjet me plotësim

Për çdo plotësim të saktë jepet një pikë.

Shembull 1: Tregoni tre elemente të barabartë në katrorin ABCD. 3 pikë

i) _____; ii) _____; iii) _____

Shembull2: Teorema e Pitagorës zbatohet në _____ dhe lidh _____ me _____. 3 pikë

e) *Pyetjet me zgjidhje të shkurtër*

- Formulimi i tyre kërkon një përgjigje të përcaktuar e të përpiktë.
- Këto pyetje kërkojnë nga 1 deri në 5 minuta kohë për t'u lexuar e për t'u përgjigjur.
- Këtu hyjnë pyetje në të cilat nxënësit i kërkohet të bëjnë një figurë, të kryejë një njehsim, të paraqesë shkurt një argumentim, të zgjidhë një ushtrim etj.
- Këto lloj pyetje kërkojnë më shumë se një miratim të thjeshtë a një kujtesë mekanike.
- Ka më pak mundësi që nxënësit ta gjejnë përgjigjen me hamendje në krahasim me pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë.

Shembull 1: Paraqit më thjesht shprehjen dhe gjej vlerën e saj me dy mënyra:

$$a^2 + ab - 2a^2 + 3a^2 - 2ab \text{ për } a = -1 \text{ dhe } b = 1 \quad 2 \text{ pikë}$$

Shembull 2: Në një klasë me 30 nxënës, mesatarja e pikëve në një testim është 88. Mesatarja e pikëve të djemve është 85 dhe mesatarja e pikëve të vajzave është 90. Sa djem e sa vajza ka klasa? 2 pikë

f) *Pyetje të strukturuar*

- Strukturimi i një pyetjeje (situatë) është zërthimi i saj në elemente përbërës me karakteristikat kryesore që meritojnë të studiohen.
- Shkalla me të cilën mësuesit do të zërthejnë një pyetje (ose situatë) varet nga natyra dhe kompleksiteti i saj, nga niveli i të mësuarit dhe aftësitë individuale të nxënësve.
- Kur pyetja (situata) është shumë komplekse dhe aftësitë nuk janë të larta duhet të rritet shkalla e strukturimit.
- Një nga funksionet e pyetjeve të strukturuar është që ta mundësojnë lidhjen midis mësimdhënies, të nxënësve dhe vlerësimit të arritjes.
- Në një pyetje të strukturuar nxënësit i kërkohet të njihet me informacionin që jepet në trugun e përbashkët të pyetjes dhe më pas t'i përgjigjet një sërë kërkesash që lidhen me përmbajtjen e këtij trugu dhe që testojnë në mënyrë progresive njohuritë e nxënësit rreth çështjes.
- Si rregull niveli i vështirësisë së këtyre pyetjeve vjen duke u rritur.
- Pyetjet duhet të jenë të pavarura nga njëra tjetra dhe përgjigja e saktë për një pyetje nuk duhet të varet nga përgjigja e saktë e pyetjes paraardhëse.

- Kur kjo nuk është e mundur të realizohet (p.sh. në pyetjet e strukturuar që kërkojnë llogaritje), atëherë gabimi që rrjedh prej përgjigjes së gabuar në pyetjen e mëparshme nuk duhet të merret në konsideratë në pikëzimin e përgjithshëm.

Shembull 1: Jepet sistemi :
$$\begin{cases} x - 3y = 3 \\ 2x + 5y = 28 \end{cases}$$

- a) A është pika M (2;3) zgjidhje e sistemit (1 pikë)
- b) Zgjidhni sistemin me mënyrën e mbledhjes (2 pikë)

Shembull 2: Jepet parabola $y=x^2+mx$.

- a) Caktoni m , në mënyrë që ajo të kalojë nga pika M(6,0) 1 pikë
- b) Për vlerën e gjetur të m , gjeni pikat A dhe B të prerjes së parabolës me drejtëzën $y=-x-4$.
2 pikë
- c) Në të njëjtin plan koordinativ, skiconi drejtëzën dhe parabolën. 2 pikë

g) Pyetje të hapura

Këto lloj pyetjesh mund të kenë disa përgjigje të sugjeruara nga nxënësit. Në këtë rast vlerësohen argumentet që jep nxënësi dhe saktësia në arsyetimin e mendimeve dhe veprimeve përkatëse.

Shembull: Sugjeroni një pyetje kërkimore që do të donit ta shqyrtonit, duke përdorur metodat statistikore. Identifikoni bashkësinë e të dhënave që do t'ju duheshin. Si do t'i mblidhnit të dhënat? Ç'madhësi kampioni do të përdornit? Ç'skallë saktësie do të përdornit?

Si rregull në pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë (1 pikë) **llogariten 60 sekonda**; për pyetjet e tjera për çdo pikë e dhënë llogaritet **90 sekonda**. Koha për përgjigjen e testit në tërësi përcaktohet paraprakisht duke mbajtur parasysh moshën e nxënësve, nivelin e shprehive të fituara nga nxënësit, shmangien e kopjimit prej tyre etj.

Nëse gjatë testimit do të lejohet përdorimi i mjeteve si p.sh. makina llogaritëse, vizore, kompasti etj., kjo duhet të përcaktohet më parë dhe të jepen udhëzimet sa dhe si do të përdoren ato. Pyetjet duhet të jenë me një nivel të përshtatshëm vështirësie (kufiri i përshtatshëm është që 20% - 80% e nxënësve t'i përgjigjen saktë pyetjes).

Nivelet e arritjeve

Arritjet e nxënësve regjistrohen dhe raportohen kundrejt niveleve të arritjes. Mësuesi duhet të përdorë nivelet e arritjes kur merr një vendim për arritjet e nxënësve në lidhje në rezultatet e të nxënësve. Nivelet e arritjes përshkruajnë nivelin në të cilën nxënësi duhet të punojë për të arritur një nivel ose notë të caktuar.

Nxënësit gjithmonë duhet të kenë një kopje të niveleve të arritjes në mënyrë që ata të dinë se çfarë duhet të bëjnë dhe të jenë në gjendje të bëjnë për të arritur në një nivel apo për të marrë një notë të

mirë në një detyrë. Nivelet e arritjes u ndihmojnë në shënimet tuaja për të orientuar nxënësit të përmirësojnë performancën e tyre në të ardhmen. Për të siguruar interpretim korrekt të niveleve të arritjeve kur mësuesi vlerëson nxënësit, duhet që të gjithë nxënësit të përfundojnë të njëjtën detyrë nën të njëjtat kushte dhe të gjithë mësuesit të përdorin të njëjtat nivele arritjesh për vendosjen e notës.

Mësuesit pastaj mund të krahasojnë punën e nxënësve dhe të vijnë në një të kuptuar të përbashkët të niveleve të arritjeve.

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësit nga nxënësi

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësit nga nxënësi i ndihmon ata të kuptojnë më shumë se si të mësojnë. Nxënësit vlerësojnë punën e tyre (vetëvlerësimin) ose punën e të tjerëve (vlerësimi i nxënësit nga nxënësi). Nxënësve duhet t'u ofrohet mundësia për të vlerësuar të nxënit e tyre dhe të nxënit e të tjerëve sipas kriterëve të përcaktuara.

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësit nga nxënësi:

- vazhdon ciklin e të mësuarit duke bërë pjesë vlerësimin e të nxënit;
- u tregon nxënësve pikat e forta dhe ku ata duhet të përmirësohen;
- angazhon nxënësit në mënyrë aktive në procesin e vlerësimit;
- u mundëson nxënësve që të jenë përgjegjës për mësimin;
- ndihmon nxënësit të kuptojnë kriteret e vlerësimit dhe nivelet e arritjes.

Vlerësoni në klasë - përdorni kohën e klasës për të kryer dhe për të vlerësuar detyrat e klasës, detyrat e shtëpisë, detyrat e portofolit, projektet, përgjigjet me gojë, prezantimet, kuizet dhe testet (me zgjedhje të shumëfishta, e saktë/ e gabuar, me çiftime, po/jo). Ky vlerësim mund të kryhet fare mirë me anë të nxënësve, është vlerësim zhvillues dhe me reagime të menjëhershme. Vlerësimet në klasë janë më të shkurtra, marrin më pak kohë për të shënuar dhe janë të dobishme, sepse japin reagime të menjëhershme mbi përparimin e nxënësve.

Zhvendosni përgjegjësinë - prezantoni vetëvlerësimin dhe vlerësimin e nxënësit nga nxënësi për të zhvilluar aftësitë e nxënësve për të vlerësuar punën e tyre dhe atë të shokëve të tyre. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësit nga nxënësi rrit sasinë e reflektimit të nxënësve. Sigurisht mësuesi mund të plotësojë vlerësimin. Nuk është e nevojshme të mbahet shënim për çdo vlerësim apo të vendoset notë për çdo vlerësim. Vlerësimi është hartuar për të përmirësuar përvoja mësimore për ju dhe për nxënësin, jo vetëm për të “akredituar” nxënësit.

Vlerësimi i nxënësve në fushën “Shoqëria dhe mjedisi”

2. VLERËSIMI I NXËNËSVE NË LËNDËN E HISTORISË

Vlerësimi është një pjesë e rëndësishme e procesit të mësimdhënie - nxënies. Vlerësimi përdoret për:

- të gjykuar mbi përpjekjet e nxënësve;
- të matur arritjet e nxënësve;
- të gjykuar dhe përmirësuar procesin e mësimdhënie -nxënie;
- të raportuar arritjet;
- t'i dhënë sugjerime nxënësve për përparimin e tyre.

Vlerësimi mat arritjet e nxënësve për rezultatet e të nxënit të përshkruara në programin mësimor. Është një proces i vazhdueshëm i identifikimit, mbledhjes dhe interpretimit të informacionit në lidhje me arritjet e nxënësit dhe mund të integrohet në të nxënit normal të nxënësve.

Qëllimi i vlerësimit: Qëllimi kryesor i vlerësimit është *përmirësimi i përmbushjes së rezultateve të të nxënit* nga nxënëi dhe i vetë procesit të të nxënit. Vlerësimi është procesi gjatë të cilit *mbledhen të dhëna dhe gjykohe për vlerën* e arritjes së rezultateve të të nxënit bazuar në nivelet e arritjes.

Vlerësimi i nxënësit kryhet nëpërmjet:

- vlerësimit të vazhduar (vlerëimi për të nxënë) (40%);
- vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse (vlerëimi i të nxënit) (40%)
- vlerësimin i portofolit lëndor të nxënësit (20%).

7.1. Vlerësimi i vazhduar (për të nxënë)

- Vlerësimi për të nxënë shpesh quhet vlerësim formativ dhe është vlerësim që mbledh të dhëna dhe dëshmi rreth të nxënit të nxënësve gjatë procesit të të mësuarit. Kjo mundëson të shihni se ku kanë nxënësit probleme dhe për të dhënë reagime të menjëhershme të cilat do t'i ndihmojnë nxënësit tuaj të mësojnë më mirë. Gjithashtu, vlerësimi për të nxënë ju ndihmon të planifikoni punën tuaj për të zhvilluar mësimin në mënyrë më efektive. *Shpesh ky vlerësim është informal* dhe nxënësit mund të mbajnë shënime vetë mbi progresin e tyre. Një shembull është një kuiz i shpejtë për të parë nëse nxënëit i kujtojnë pikat e rëndësishme të mësimit të kaluar.
- Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe gjykimet e mësuesit mbi *përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, punët individuale, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës etj.*, përgjatë një periudhe.
- Për vlerësimin e vazhduar të arritjes së rezultateve të të nxënit, mësuesi mban shënime në evidencë (fletore) për çdo nxënë. Shënimet në evidencë mësuesi i përcakton sipas mënyrës së

tij kryesisht me simbole të shoqëruara me komente, të cilat i referohen niveleve të arritjes së kompetencave matematikore, por edhe me notë në raste specifike siç janë kuize të shkurtra.

- Komenti përmban nivelin e arritjes duke e shënuar me simbolin përkatës (**p.sh., N₃ ose N₄**), si dhe *konceptin përkatës* për të cilin është vëzhguar nxënësi, psh N3 “Origjina e ilirëve” ose N2 “Organizimi ekonomik” ose N4 “Organizimi shoqëror”.

Shembull: Histori (klasa IX.)

Periudha: shtator - dhjetor

Nr.	Nxënësi	Data/muaji						Komentet janë: Nivelet e arritjes për njohurinë/konceptin përkatës
		19.09	19.09	03.10	03.10	07.11	07.11	
1	Alisa Kodra	✓						N3.Epoka e gurit
				++				N4.Mbretëria Ardiane
							++	N.4. Kultura e Komanit

Legjendë: ++ (sh. mirë); + (mirë); +- dhe ✓ (mesatar); -+ dhe ? (nën mesatar); - dobët; - - (sh. dobët). N1- Niveli 1; N2 – Niveli 2; N3 – Niveli 3; N4 – Niveli 4. Në përfundim të periudhës tremujore, vlerësimi i vazhduar mbyllet me një notë përmbledhëse (NVv).

- Nota e vlerësimit të vazhduar në këtë rast gjykohet në bazë të ecurisë (progresit ose regresit) të arritjeve të nxënësit përgjatë periudhës, pra **NVv është 10**. Në shembullin e mësipërm ecuria e nxënësit është progresive, por mund të jetë edhe regressive.
- Evidenca (fletorja e shënimeve) menaxhohet nga vetë mësuesit. Mësuesi është i lirë të ndryshojë formatin e evidencës duke ruajtur llogjikën e vlerësimit për të nxënë dhe të përcaktojë vet se si do të mbajë shënimet për ecurinë e nxënësit.

7.2. Vlerësimi i të nxënit (testi përmbledhës)

- Vlerësimi i të nxënit quhet shpesh vlerësim përmbledhës. Përdoret për të mbledhur prova dhe të dhëna që tregojnë nëse mësimdhënia ka realizuar qëllimin e saj. Zakonisht planifikohet në fund të një njësie apo të një periudhe të caktuar. Ky është një vlerësim formal dhe kryhet edhe për efekt raportimi. Në përfundim të periudhës (kur e vendos mësuesi) kryhet **vlerësimi me test përmbledhës**, e cila ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni për periudhën përkatëse. Testi ose detyra përmbledhëse planifikohet nga mësuesi kur përmbillet një grup rezultatesh të të nxënit dhe mësuesi është i lirë ta vendosë vetë se kur do ta zhvillojë atë.
- Testi përmbledhës është 45 min.
- Drejtorja e shkollës menaxhon organizimin e testeve sipas një grafiku në mënyrë që të mos ngarkohet nxënësi në fund të periudhës. (Testi jodomosdoshmërisht bëhet në fund të

periudhës. Mësuesi e gjykon vetë kohën se kur do të zhvillojë testin përmbledhës. Shih shembullim të planifikimi i lëndës për një periudhë).

2.3. Vlerësimi i portofolit lëndor të nxënësit

- Portofoli është koleksionim sistematik i detyrave dhe punimeve të kryera nga nxënësi për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohurive, shkathtësive, qëndrimeve).
- Në fillim të periudhës, mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, përcaktojnë detyrat që do të përfshijnë në portofol përgjatë periudhës, në varësi të specifikave të lëndës.
- Mësuesi në fillim të periudhës përcakton dhe ju prezanton nxënësve peshat/pikët për vlerësimin e secilës detyrë.
- Mësuesi udhëzon nxënësit për krijimin dhe zhvillimin e portofolit dhe bashkëpunon me ta rreth përmbajtjes së tij.
- Mësuesi monitoron përgjatë gjithë periudhës zhvillimin e detyrave të portofolit.

a) Struktura e portofolit:

Portofoli i nxënësit duhet të përmbajë detyra/punë hulumtuese/projekte të nxënësve që tregojnë *kompetencat apo rezultatet e të nxënësve* për t'u arritur në një lëndë. Detyrat e portofolit nuk janë pjesë e vlerësimit të vazhduar të nxënësit.

Për një periudhë, portofoli duhet të përmbajë dy- tre detyra përfshirë projektin kurrikular.

- Projekti ose një fazë e tij është pjesë e detyruar e portofolit për çdo periudhë.
- 1 -2 detyra krijuese, zbatuese, hulumtuese etj.

Detyrat e portofolit duhet të jenë me të njëjtën temë për çdo nxënësi. Detyrat e portofolit mund të jenë punime të kryera në klasë dhe/ose jashtë saj, dëshmi e kontributeve dhe talentit të nxënësit, me karakter hulumtues dhe krijues të tilla si:

- punë praktike individuale,
- produkte të krijuara nga nxënësit,
- punime audio-vizuale,
- aktivitet në grup ose individual;
- projekte individuale ose në grup;
- etj.

Kujdes! Detyrat NUK duhet të jenë domosdoshmërisht të punuara me kompjuter.

b. Vlerësimi i portofolit

Vlerësimi i portofolit përcaktohet nga pesha/pikët që secili mësues i vendos çdo detyre të portofolit. Mësuesi i vendos peshat/pikët në varësi të llojit të detyrës. Vlerësimi i secilës detyrë të portofolit bëhet mbi bazë të kriterëve që mësuesi vendos bazuar në llojin e detyrës së dhënë. Detyrat e portofolit vlerësohen në përgjithësi kur ato dorëzohen dhe nuk lihen për në fund kur vlerësohet i gjithë portofoli.

Vlerësimi i portofolit mund të planifikohet si orë e veçantë në planifikimin e periudhave ose mund të realizohet përgjatë tre – katër orëve të fundit të periudhës. Në këtë rast mësuesi përcakton një grafik të nxënësve të cilëve do t'u vlerësohet portofoli. *Mësuesi duhet të kujdeset që të mos mbingarkojë nxënësin me detyra në përfundim të periudhës. Ai, gjithashtu, mund të rakordojë punën me mësuesit e lëndëve të tjera për të menaxhuar ngarkesën e nxënësve.*

Shembull portofoli në lëndën e historisë

Në lëndën e historisë, mësuesi mund të planifikojë të paktën 3 detyra për portofolin lëndor (përfshirë edhe projektin kurrikular vjetor dhe ose me shtrirje tremujore). Në shembullin më poshtë, mësuesi, në bashkëpunim me nxënësit, ka përcaktuar 3 detyra për portofolin e periudhës së dytë, i cili do të ketë gjithsej 30 pikë. Për vlerësimin e portofolit mësuesi **përcakton vetë** pikët

për secilën detyrë. (Më poshtë është dhënë thjesht një shembull, pikët e të cilit shërbejnë për të ilustruar modelin dhe mund të mos përdoren domosdoshmërisht nga mësuesi).

Klasa e gjashtë

Tremujori i dytë

Detyrat për portofol

1. Ndërton hartën e Evropës mesjetare dhe vendos shtet-kombet 5 pikë
2. Lidhja e shqiptarëve me qytetërimet evropiane të shek. XV. 10 pikë
3. Projekt me temë “Jeta dhe veprimtaria e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu”. Faza e dytë. 15 pikë

- Në detyrën e parë me temë “Ndërton hartën e Evropës mesjetare dhe vendos shtet-kombet” e cila është e karakterit zbatues vlerësohet saktësia e paraqitjes së informacionit (ndërton hartën e kontinentit evropian, përcakton shtet kombet dhe i vendos ato në hartë duke shënuar emërtimet e tyre.
- Në detyrën e dytë vlerësohet përdorimi i burimeve të informacionit, përzgjedhja e informacionit për të bërë lidhjen e shqiptarëve me qytetërimet evropiane të shek. XV, pra vlerësohet kërkimi, përzgjedhja e informacionit, origjinaliteti, krijimtaria.
- Në detyrën e tretë (fazën e dytë të projektit) vlerësohet përzgjedhja e burimeve të informacionit dhe materialeve që do të prezantohen, puna individuale dhe bashkëpunimi në grup.

Mësuesi përcaton tabelën e pikëve (si rasti i testeve).

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	>7	8-11	12-15	16 - 19	20-23	24-27	28-30

Në shembullin e mësipërm nxënësi vlerësohet nga mësuesi si më poshtë:

Detyra	Detyra 1	Detyra 2	Detyra 3	Portofoli
Pikë	4 pikë	9 pikë	12 pikë	25 pikë

Vlerësimi me pikë i këtij për portofolin e këtij nxënësi është nota 9 (nëntë)

Shëmbull portofoli:

Histori 7

Tremujori i parë

Detyrat e përzgjedhura për portofol dhe pikët/peshat për cdo detyrë janë:

- *Ndërtimi i hartës së zbulimeve gjeografike duke vendosur emrat e zbuluesve, rrugët e ndjekura nga ata, vendet e zbuluara dhe kohën kur u zbuluan.*

10 pikë

- *Hulumtimi për ndikimin e trashëgimisë osmane në art, kulinari dhe kulturë në qytetin/zonën ku jetojmë.*

15 pikë

- *Projekti kurrikular vjetor me temë: Rilindja Shqiptare, zgjimi i ndërgjegjes kombëtare në Shqipëri gjatë shekujve XIX dhe fillimit të shekullit XX. (Faza e parë- përcaktimi i grupeve përcaktimi i çështjeve që do të trajtohen në brendi të tij, përzgjedhja e burimeve.*

15 pikë

Rezultatet e të nxënit:

- Përcakton rrugët që ndoqën zbuluesit për të zbuluar territore të reja;
- Bën lidhjen mes zbuluesve dhe territoreve që ata zbuluan;
- Përcakton kohën kur u zbuluan territoret e reja;
- Përdor njohuritë e marra në gjeografi për ndërtimin e hartës së zbulime gjeografike;
- Akseson burime të testuara për të gjetur informacion për gjurmët e trashëgimisë osmane në zonën ku jeton;
- Përzgjedh informacionin e kërkuar;
- Jep mendimin e tij/saj për ndikimin e trashëgimisë osmane në art, kulturë dhe kulinari;
- Harton pyetje;
- Zhvillon intervista;
- Diskuton për çështjet ku të fokusohet projekti;
- Punon individualisht dhe në grup;
- Prezanton gjetjet duke bërë lidhjet shkak-pasojë dhe i shpjeguar ato.

Grupimi i rezultateve të të nxënit sipas niveleve të arritjes

Kërkesat e nivelit 2 (nota 5-6)

Nxënësi në këtë nivel:

- *Identifikon ndonjë nga zbuluesit dhe bën ndonjë nga lidhjet mes tyre dhe territorit të zbuluar prej tyre;*
- *Identifikon ndonjë nga vitet në të cilat u zbuluan territoret e reja;*
- *Identifikon ndonjë nga burimet e informacionit;*
- *Identifikon ndonjë nga ndikimet e trashëgimisë osmane në kulinari apo jetën e përditshme;*

Kërkesat e nivelit 3 (nota 7-8)

Nxënësi në këtë nivel:

- *Vendos në hartë disa nga zbuluesit dhe bën lidhjet mes tyre dhe territoreve që zbuluan*
- *Shënon disa nga vitet e zbulimeve gjeografike;*

- përdor disa nga konceptet historike;
- akseson disa nga burimet informacionit;
- Përzgjedh informacion për disa nga ndikimet e qytetërimit osman në zonën ku jeton;
- Harton disa nga pyetjet për intervistën
- Drejton pyetje;
- Jep mendimin e tij/saj jo gjithmonë të mbështetur në argumente;
- Prezanton gjetjet duke shpjeguar disa nga lidhjet shkak-pasojë;

Kërkesat e nivelit 4 (nota 9-10)

- Ndërton saktë hartën e zbulimeve gjeografike duke bërë lidhjet mes zbuluesve, territoreve që zbuluan dhe vitet në të cilat i zbuluan;
- Përzgjedh burimet të testuara informacioni;
- Përzgjedh informacionin e duhur për detyrën e dhënë;
- Jep mendimin e tij/saj për ndikimin e trashëgimisë osmane në art, kulturë dhe kulinari;
- Harton pyetje;
- Zhvillon intervista;
- Prezanton gjetjet duke shpjeguar lidhjet shkak –pasojë;
- Përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik për të shpjeguar të shkuarën.

Vlerësimi i portofolit me notë

Mësuesi përcaton tabelën e pikëve (si rasti i testeve).

Nota	5	6	7	8	9	10
Pikë	8-14	15-20	21-25	26-30	31 – 35	36 – 40

Në shembullin e mësipërm nxënësi vlerësohet nga mësuesi si më poshtë:

Detyra	Detyra 1	Detyra 2	Detyra 3	Portofoli
Pikë	7 pikë	10 pikë	15 pikë	32 pikë

Vlerësimi me pikë i këtij për portofolin e këtij nxënësi është nota 9 (nëntë).

2.4. Vlerësimi periodik

Vlerësimi periodik bëhet në përfundim çdo periudhe dhe përmban tri nota:

- *Nota e vlerësimit të vazhdueshëm (NVv)*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.
- *Nota e vlerësimit me test ose me detyrë përmbledhëse (NTp)*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.
- *Nota e vlerësimit të portofolit lëndor (NVp)*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.

2.5. Vlerësimi përfundimtar

Vlerësimi përfundimtar shënohet në regjistër duke plotësuar kolonat “Vlerësimi vjetor” dhe në kolonën “Nota përfundimtare”. Vlerësimet vjetore përmbajnë:

- Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar që është rezultat i tri periudhave.
- Notën vjetore të vlerësimit me test ose detyrë përmbledhëse që është rezultat i tri periudhave.
- Notën vjetore të vlerësimit të dosjes së nxënësit që është rezultat i tri periudhave.

Në rast kur ecuria e nxënësit është e dukshme progresive ose regresive gjatë dy periudhave të fundit, vlerësimi i tij vjetor në secilën nga rubrikat mund të jetë progresiv ose regresiv. Në rast kur ecuria e tij nuk është e qëndrueshme përgjatë tri periudhave, atëherë vlerësimi llogaritet me mesatare.

Nota përfundimtare llogaritet me përqindje për secilën nga rubrikat

Tabela: Pesha në përqindje e llojeve të vlerësimit

Lloji i vlerësimit	Pesha në përqindje
Vlerësimi i vazhdueshëm	40%
Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse	40%
Vlerësimi i portofolit të nxënësit	20%

Shënim: Nxënësi ka 9 nota në regjistër për çdo lëndë deri në përfundim të vitit shkollor.

Hapat për njehsimin e notës përfundimtare janë:

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NVV), bazuar në tre notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Përcaktohet nota vjetore e testit/detyrës përmbledhëse (NTP) bazuar në tre notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NVP) bazuar në tre notat e periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
- Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh., 8,8 ≈ 9).

$$(NVV \times 0.4) + (NTP \times 0.4) + (NVP \times 0.2) = \text{Nota përfundimtare}$$

Përshkrimi i notës përfundimtare vjetore argumenton nivelin e arritjeve të kompetencave të fushës/lëndës. Përshkrimi i referohet pikave më të forta që ka nxënësi lidhur me përmbushjen e kompetencave të lëndës

Shembull 1: Histori, klasa VII

Tremujori I			Tremujori II			Tremujori III			Notat vjetore			Nota përfundimtare
NV V	NTP	NVP	NV V	NTP	NVP	NV V	NTP	NVP	NV V	NTP	NVP	
6	7	8	8	7	9	8	7	9	8	7	9	8

$$(8 \times 0.4) + (7 \times 0.4) + (9 \times 0.2) = 7.8$$

Nota përfundimtare 8

Nota përfundimtare	Përshkrimi i vlerësimit
8	Ajla formulon një numër të caktuar pyetjesh, përdor disa nga konceptet historike, jep shpjegime të përgjithshme, shfrytëzon burime historike dhe përzgjedh informacionin për ndërtimin e ngjarjes historike, shpjeguar dhe komunikuar atë. Kërkon ndihmë për organizimin e informacionit dhe e prezanton atë në mënyrë koherente.

2.6. Nivelet e arritjeve

Arritjet e nxënësve regjistrohen dhe raportohen kundrejt niveleve të arritjes. Mësuesi duhet të përdor nivelet e arritjes kur merr një vendim për arritjet e nxënësve në lidhje në rezultatet e të nxënit. Nivelet e arritjes përshkruajnë nivelin në të cilën nxënësi duhet të punojë për të arritur një nivel ose notë të caktuar.

Nxënësit gjithmonë duhet të kenë një kopje të niveleve të arritjes në mënyrë që ata të dinë se çfarë duhet të bëjnë dhe të jenë në gjendje të bëjnë për të arritur në një nivel apo për të marrë një notë të mirë në një detyrë. Nivelet e arritjes ju ndihmojnë në shënimet tuaja për të orientuar nxënësit të përmirësojnë performancën e tyre në të ardhmen. Për të siguruar interpretim korrekt të niveleve të arritjeve kur mësuesi vlerëson nxënësit, duhet që të gjithë nxënësit të përfundojnë të njëjtën detyrë nën të njëjtat kushte dhe të gjithë mësuesit të përdorin të njëjtat nivele arritjesh për vendosjen e notës.

Mësuesit pastaj mund të krahasojnë punën e nxënësve dhe të vijnë në një të kuptuar të përbashkët të niveleve të arritjeve.

(Shih zbërthimin e niveleve të arritjeve te modeli i planifikimit ditor, portofol, projekti, apo te modeli i testit)

2.7. Vetvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësit nga nxënësi

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësit nga nxënësi i ndihmon ata të kuptojnë më shumë se si të mësojnë. Nxënësit vlerësojnë punën e tyre (vetëvlerësimin) ose punën e të tjerëve (vlerësimi i nxënësit nga nxënësi). Nxënësve duhet t'u ofrohet mundësia për të vlerësuar të nxënit e tyre dhe të nxënit e të tjerëve sipas kriterëve të përcaktuar.

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësit nga nxënësi:

- vazhdon ciklin e të mësuarit duke bërë pjesë vlerësimit të nxënit;
- u tregon nxënësve pikat e forta dhe ku ata duhet të përmirësohen;
- angazhon nxënësit në mënyrë aktive në procesin e vlerësimit;
- u mundëson nxënësve që të jenë përgjegjës për mësimin;
- ndihmon nxënësit të kuptojnë kriteret e vlerësimit dhe nivelet e arritjes.

Vlerësoni në klasë - përdorni kohën e klasës për të kryer dhe për të vlerësuar detyrat e klasës, detyrat e shtëpisë, detyrat e portofolit, projektet, përgjigjet me gojë, prezantimet, kuizet dhe testet (me zgjedhje të shumëfishta, e saktë/ e gabuar, me çiftime, po/jo). Ky vlerësim mund të kryhet fare mirë me anë të nxënësve, është vlerësim zhvillues dhe me reagime të menjëhershme. Vlerësimet në klasë janë më të shkurtra, marrin më pak kohë për të shënuar dhe janë të dobishme, sepse jepen reagime të menjëhershme mbi përparimin e nxënësve.

Zhvendosni përgjegjësinë - prezantoni vetëvlerësimin dhe vlerësimin e nxënësit nga nxënësi për të zhvilluar aftësitë e nxënësve për të vlerësuar punën e tyre dhe atë të shokëve të tyre. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësit nga nxënësi rrit sasinë e reflektimit të nxënësve. Sigurisht mësuesi mund të plotësojë vlerësimin. Nuk është e nevojshme të mbahet shënim për çdo vlerësim apo të vendoset notë për çdo vlerësim. *Vlerësimi është hartuar për të përmirësuar përvoja mësimore për ju dhe për nxënësin, jo vetëm për të "akredituar" nxënësit.*

3. KRITERET E HARTIMIT DHE TË VLERËSIMIT TË TESTIT NË HISTORI

Një test është një vlerësim formal, përmbledhës, i strukturuar i arritjeve të nxënësve dhe i progresit të nxënësit. Testet janë një aspekt i rëndësishëm i procesit të mësimdhënies - nxënies nëse ata janë të integruar në "rutinën" e klasës dhe nuk trajtohen thjesht si një strategji "përmbledhëse". Ata i lejojnë nxënësve të monitorojnë progresin e tyre dhe ofron informacion të vlefshëm për mësuesin në planifikimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies - nxënies. Testet ndihmojnë në nxënien e nxënësve nëse ato janë të lidhura qartë me mësimin dhe

rezultatet e të nxënit. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që testet të korrigjohen dhe nxënësve t'u jepet përshtypja për performancën e tyre. Testet e hartuara në klasë zbulojnë rreth njohurive të nxënësve për përmbajtjen dhe për zhvillimin e të menduarit. Përgjithësisht pyetjet e hapura japin informacion më të detajuar në lidhje me aftësitë e nxënësve sesa një pyetje në të cilën ka vetëm një përgjigje.

8.1 Parimet e hartimit të testeve nga mësuesi

Testet lejojnë shumëllojshmëri mënyrash të demonstrimit të aftësive të nxënësve. Prandaj:

- nxënësit duhet të kuptojnë qëllimin dhe vlerën e testit;
- testi duhet të masë arritjen e rezultateve të të nxënit për një kapitull ose periudhë të caktuar;
- duhen dhënë udhëzime të qarta për secilën pjesë të testit;
- pyetjet duhet të ndryshojnë nga më e thjeshta te ajo më komplekse;
- pikët duhet të jepen për çdo pyetje apo rubrikë të testit;
- pyetjet duhet të jenë të llojeve të ndryshme (po/jo, e saktë/e gabuar, me zgjedhje të shumëfishtë, çiftim i elementeve, plotësim i vendeve bosh, zëvendësim i elementeve; përgjigje e zgjeruar, përgjigje e shkurtër etj.)

Testet duhet:

- të jenë të lehtë për t'u lexuar dhe të ketë hapësirë ndërmjet pyetjeve për të lehtësuar leximin dhe shkrimin;
- të përfshijnë një sërë rezultatesh të nxëni;
- të mund të kryhen nga nxënësit me nevoja të veçanta;
- i krijojnë mundësi nxënësve të zgjedhin kërkesat e ushtrimeve në mënyrë të pavarur nga njëra – tjetra;
- të kenë nivele të ndryshme të pyetjeve për të përfshirë mbledhjen, përpunimin dhe zbatimin e informacioneve;
- të llogariten me kohë të mjaftueshme për të përfunduar të gjithë nxënësit;
- të mos ngatërrohen me minitestet të cilat masin rendimentin e orës së mësimit dhe kanë vetëm një kërkesë.

Gjatë ndërtimit të testeve të arritjes për një grup njohurish të lëndës mësuesi duhet të ketë në konsideratë:

- Numri i pyetjeve në teste varet nga ajo çfarë do të testohet. Ky numër është i ndryshëm kur synohet testimi i përvetësimit të një koncepti, i përvetësimit të një mësimi, i përvetësimit të një kapitulli, i përvetësimit të lëndës së një periudhe, i përvetësimit vjetor të lëndës etj.
- Është mirë që testet të hartohen me pyetje të llojeve të ndryshme; pyetje të strukturuar, me alternativa, i pyetjeve me zgjidhje të shkurtër.
- Pyetjet në test është mirë të rradhiten sipas shkallës së vështirësisë së tyre.
- Numri i pyetjeve të testit varet edhe nga koha në dispozicion, kjo kohë mesatarisht duhet të jetë 45 minuta.
- Gjatë hartimit të një testi është shumë e rëndësishme vlefshmëria e pyetjeve të tij (d.m. th. garantimi i asaj që testi në tërësi duhet të vlerësojë ato koncepte, njohuri, aftësi e shprehje që ne i kemi vënë vetes si qëllim të kontrollojmë).

8.2. Hartimi i testit

Hartimi i testit në lëndën e Historisë bazohet te bazat metodologjike të hartimit të testeve. Për hartimin e testit ndërmerren hapat e mëposhtëm:

- 1) Përcaktimi i listës së koncepteve që do të testohen me peshën përkatëse (% e pikëve që do të zënë secili koncept kryesor në test) si dhe rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave historike.
- 2) Përcaktimi i peshës së niveleve që do të zbatohet në test. Niveli i dytë i arritjes së kompetencave (rekomandohet 40%) përfshin pyetje ku kërkohet që nxënësi të zbatojë një procedurë rutinë, mjaft të ushtruar në klasë. Niveli i tretë i arritjes së kompetencave (rekomandohet 40%) përfshin pyetje ku nxënësit nuk i mjafton të kujtojnë procedura rutinë, as të imitojnë zgjidhje standarde. Ai duhet të ndjehet para një situatë më komplekse, të cilën, sidoqoftë mund ta zgjidhë duke kombinuar njohuritë që disponon. Niveli i katërt i arritjes së kompetencave (rekomandohet 20%) përfshin pyetje ku nxënësi gjykon, zgjidh, jep mendim, vlerëson, harton duke vënë në dispozicion njohuritë e tij.
- 3) Ndërton tabelën e specifikimit (Tabela e Blue –Printit);

Konceptet	Përqindja = Pikët	Rezultatet e të nxënësve	Niveli II i arritjes së kompetencave	Niveli III i arritjes së kompetencave	Niveli IV i arritjes së kompetencave

.....
Pikët total të testit	100% = ... pikë		30% - 40% = ... pikë Ose 35%	40% - 45% = ... pikë Ose 40%	20% - 25% = ... pikë Ose 25%

Tabela na ndihmon për të marrë këto informacione për përmajtjen e testit:

- A përmban testi pyetje për të gjithë rezultatet e të nxënit që përmban programi?
- Sa pyetje duhet të përmbaje testi për secilin rezultat të nxëni?
- A është përcaktuar një ekuilibër në përzgjedhjen e pyetjeve që ka testi dhe njohurive brenda temave mësimore?
- A është specifikuar secili rezultat i të nxënit sipas tre niveleve të arritjeve të kompetencave lëndore?

4) Hartimi i pyetjeve të testit.

5) Hartimi i skemës së vlerësimit (Bazuar në teoremën e Gausit).

- Skema e vlerësimit u vjen në ndihmë mësuesve për të bërë vlerësimin e standardizuar për të gjithë nxënësit. Skema shmang çdo lloj fiktiviteti gjatë korrigjimit të testit.
- Vendosja e pikëve për çdo kërkesë bëhet mbi bazën e çdo hapi që nxënësi ndërmerr gjatë zgjedhjes së kërkesës, të cilat pasqyrohenin qartë në skemën e qortimit.
- Vlerësimi me pikë i kërkesave që përmban testi është pjesa më e rëndësishme e hartimit të tij. Në vlerësimin përfundimtar merret parasysh dallimi në vlerësimin e nxënësit, i cili përcaktohet nga niveli i arritjeve.
- Një faktor mjaft i rëndësishëm në vlerësimin përfundimtar është hartimi i saktë i skemës së pikëzimit të testit dhe konvertimi i pikëve në notë sipas teoremës së Gausit.

Hartimi i skemës së vlerësimit (skema e qortimit)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
------	---	---	---	---	---	---	----

Pikë	0-7	8-14	15-20	21-25	26-30	31 - 35	36 - 40
------	-----	------	-------	-------	-------	---------	---------

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Përqindjet	<25%	25-38%	39-51%	52-64%	65-77%	78-90%	91-100%

Skema më e saktë (teorema e Gausit)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikë	0-8	9-15	16-22	23-28	29-33	34-37	38- 40
	+8	+6	+6	+5	+4	+3	+2

Tabela e vlerësimit për një test me 40 pikë

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikë	0-7	8-14	15-20	21-25	26-30	31 - 35	36 - 40

3.3. Llojet e pyetjeve që hartohen në teste

Llojet e pyetjeve që mund të përdoren në teste mund të paraqiten si më poshtë:

1. Pyetje me alternativa (me zgjedhje të shumëfishtë).

- Një pyetje me zgjedhje të shumëfishtë përbëhet nga dy pjesë: nga trunghi dhe përgjigjet alternative ndër të cilat dallohet përgjigja e vetme e saktë.
- Alternativat duhet të vendosen vertikalisht pas përmbajtjes së pyetjes, në përputhje me rendin alfabetik.
- Nuk duhet të përdoren alternativa që përplasen me njëra - tjetrën.
- Pyetjet ndërtohen në përgjithësi me 4 alternativa.
- Alternativat duhet të kenë gjatësi të njëjtë.
- Alternativat duhet të jenë homogjene dhe t'í referohen të njëjtës kategori.
- Në alternativa nuk duhet të ketë mbivendosje të dhënash apo intervalesh kohore.
- Vetëm një alternativë është e saktë.
- Pyetja me alternativë vlerësohet me një pikë.
- Në përgjithësi rekomandohet të mos përdoren si alternativa shprehjet “asnjë nga të mësipërmet”, ose “të gjitha të mësipërmet”.

- Pyetjet me alternativa shmangin në shkallë të lartë subjektivitetin në pikëzim.

Shembull: Më 11 gusht 1789 Asambleja Kushtetuese në Francë shpalli me ligj

- Vendosjen e feudalizmit
- Vendosjen e kapitalizmit
- Heqjen e feudalizmit
- Heqjen e kapitalizmit

2. Pyetjet “Po/Jo” ose “e vërtetë/ e gabuar”

- Përgjigja e saktë për këto lloj pyetjesh vlerësohet me një pikë.

Shembull: Në fjalinë e mëposhtëme vendos gërmën “V” për pohimet e vërteta dhe gërmën “G” për pohimet e gabuara.

Fenikasit shtriheshin në territoret e Libanit të sotëm. _____

3. Pyetjet me çiftim

- Për çdo çiftim të saktë jepet një pikë, pra nëse ushtrimi ka 4 kombinime nga të dy kollonat, ai do të marrë 4 pikë, nga 1 për çdo kombinim të saktë.

Shembull: Lidh me shigjetë vitet me shekujt në të cilët bëjnë pjesë.

- | | |
|------------------|----------------|
| a) Viti 211 pr.k | Shek. XX |
| b) Viti 365 | Shek. III pr.k |
| c) Viti 1901 | Shek. X pr.k |
| d) Viti 901 pr.k | Shek. IV |

4. Pyetjet me plotësim

- Për çdo plotësim të saktë jepet një pikë

Shembull 1: Plotëso tabelën duke shënuar një nga arritjet e qytetërimeve të mëposhtëme në fushën e ekonomisë.

Qytetërimi	Arritjet
Në Mesopotami	
Në Egjipti	
Fenikas	

Shembull 2: Plotëso fjalinë e mëposhtëme.

2 pikë

Perandria Romake e Perëndimit merr fund në shek _____, ndërsa Perandoria Romake e Lindjes do të vazhdojë të ekzistojë edhe për _____ vjet të tjerë.

5. Pyetje të strukturuar

- Strukturimi i një pyetjeje (situatë) është zërthimi i saj në elemente përbërës me karakteristikat kryesore që meritojnë të studiohen.
- Shkalla me të cilën mësuesit do të zërthejnë një pyetje (ose situatë) varet nga natyra dhe kompleksiteti i saj, nga niveli i të mësuarit dhe aftësitë individuale të nxënësve.
- Kur pyetja (situata) është shumë komplekse dhe aftësitë nuk janë të larta duhet të rritet shkalla e strukturimit.
- Një nga funksionet e pyetjeve të strukturuar është që ta mundësojnë lidhjen midis mësimdhënies, të nxënësve dhe vlerësimit të arritjes.
- Në një pyetje të strukturuar nxënësit i kërkohet të njihet me informacionin që jepet në trugun e përbashkët të pyetjes dhe më pas t'i përgjigjet një sërë kërkesash që lidhen me përmbajtjen e këtij trugu dhe që testojnë në mënyrë progresive njohuritë e nxënësve rreth çështjes.
- Si rregull niveli i vështirësisë së këtyre pyetjeve vjen duke u rritur.
- Pyetjet duhet të jenë të pavarura nga njëra tjetra dhe përgjigjia e saktë për një pyetje nuk duhet të varet nga përgjigjia e saktë e pyetjes paraardhëse.

Shembull: Rendit tre nga pasojat e dyndjeve të popujve në Perandorinë Romake të Perëndimit.

6. Pyetje të hapura

- Këto lloje pyetjesh mund të kenë disa përgjigje të sugjeruara nga nxënësit. Në këtë rast vlerësohen argumentet që jep nxënësi dhe saktësia në arsyetimin e mendimeve dhe veprimeve përkatëse.

Shembull : Ese argumentuese - Vlerëso figurën e Napoleon Bonapartit

3.4. Model testi

Shembull 1. Testi përmbledhës periudha e parë; 45 minuta; Klasa VI

Tematika	Tema	Konceptet kyçe
----------	------	----------------

<ul style="list-style-type: none"> - Qytetërimet botërore në Antikitët. Luginat lumore, djepi i qytetërimeve të hershme (mijëvjeçari IV – II pr. Krishtit); - Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut (shekulli VII pr.K. – shekullin V ps. K.) 	<ul style="list-style-type: none"> - Ndarja dhe llogaritja e kohës në histori; - Lindja e qytetërimeve në luginat lumore; - Qytetërimi në Mesopotami; Qytetërimi Egjiptian; - Kultura dhe besimi në Mesopotami dhe Egjipt; Parailirët dhe ilirët; - Qytetërimi në brigjet e detit Mesdhe; - Qytetërimi grek; - Qytetërimi romak; - Ndërprerja e qytetërimit antik në Europë fillimi i qytetërimit mesjetar. 	<ul style="list-style-type: none"> - Logaritja e kohës në histori, - qytetërim, - lugina lumore, - kode, - shpikje, - shkrimi dhe llojet e tij, - politeizëm, - etnosi ilir, - popuj të detit; - fenikas; - oligarki; - demokraci; - plebenj; - skllevër; - perandori; - monoteizëm; - letërsi; - dyndje (migrim);
---	---	--

Përcaktimi i rezultateve kryesore të të nxënësve që do të testohen dhe grupimi i tyre sipas niveleve:

Rezultatet e të nxënësve për njohuritë/ aftësitë që do të testohen	Grupimi i rezultateve të të nxënësve sipas niveleve të arritjes
---	--

<ul style="list-style-type: none"> - Përkufizon konceptet; - Identifikon çështje të tilla si: Pse, kur dhe si lindën qytetërimet në Mesopotami, Egjipt, Greqi e Romë; - Identifikon elementet e reja të shoqërive të qytetërimeve antike si organizimet e para shtetërore; - Përcakton qytetërimin e parë që ofroi qeverisje me dinasti mbretërore; - Dallom arritjet e kulturën materiale dhe shpirtërore të qytetërimeve antike ne brigjet e lumenjve dhe deteve (Mesopotami, Egjipt, Greqi, Romë); - Kryen veprime për llogaritjen e kohës para dhe pas Krishtit; - Përkufizon konceptet: demokraci, oligarki, republikë, kodi hamurabit; - Përcakton cilët ish-in banorët e hershëm të Ballkanit; - Përcakton vendet se ku janë gjetur gjurmë të hershme ilire; - Përcakton shtrirjen e fenikasve; - Përcakton formën e qeverisjes në Athinë dhe vitin e themelimit të Romës; - Vendos kohën kur ra Perandoria Romake e Perëndimit dhe kohëzgjatjen e Perandorisë Romake të Lindjes; - Argumenton lindjen e qytetërimit antik në luginat lumore; - Krahason rolin dhe rëndësinë e shtresave shoqërore (demosi dhe plebnjtë) në Athinën dhe Romën e lashtë; - Prezanton pasojat e dyndjeve të popujve në Perandorinë Romake të Perëndimit. 	<p>Niveli 2 (nota 5-6)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dallom ndonjë nga format e qeverisjes dhe e përkufizon atë; - Përcakton se kodi Hamurabit bazohej në ligj; - Përcakton qytetërimin e parë që ofroi qeverisje me dinasti mbretërore; - Dallom ndonjë nga arritjet e kulturën materiale dhe shpirtërore të qytetërimeve antike ne brigjet e lumenjve dhe deteve (Mesopotami, Egjipt, Greqi, Romë); - Kryen ndonjë nga veprime për llogaritjen e kohës para dhe pas Krishtit; - Përkufizon konceptet: demokraci, oligarki, republikë, etnos ilir; - Përcakton ndonjë nga banorët e hershëm të Ballkanit; - Përcakton ndonjë nga vendet se ku janë gjetur gjurmë të hershme ilire; <p>Niveli 3 (nota 7-8)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikon çështje të tilla si: kur dhe si lindën qytetërimet në Mesopotami, Egjipt, Greqi e Romë; - Identifikon disa nga elementet e reja të shoqërive të qytetërimeve antike si organizimet e para shtetërore; - Përcakton qytetërimin e parë që ofroi qeverisje me dinasti mbretërore; - Dallom disa nga arritjet e kulturën materiale dhe shpirtërore të qytetërimeve antike ne brigjet e lumenjve dhe deteve (Mesopotami, Egjipt, Greqi, Romë); - Kryen disa nga veprime për llogaritjen e kohës para dhe pas Krishtit; - Përkufizon disa nga konceptet: demokraci, oligarki, republikë, etnos ilir; - Përcakton ndonjë nga banorët e hershëm të Ballkanit; - Përcakton vendet se ku janë gjetur gjurmë të hershme parailire; - Përcakton shtrirjen e fenikasve; - Përcakton formën e qeverisjes në Athinë ; - Vendos kohën kur ra Perandoria Romake e Perëndimit dhe kohëzgjatjen e Perandorisë Romake të Lindjes; - Vendos kohën kur ra Perandoria Romake e
--	--

	<p>Perëndimit dhe kohëzgjatjen e Perandorisë Romake të Lindjes;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Argumenton në mënyrë të pjesshme lindjen e qytetërimit antik në luginat lumore; - Prezanton disa nga pasojat e dyndjeve të popujve në Perandorinë Romake të Perëndimit.
	<p>Niveli 4 (nota 9-10)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikon çështje të tilla si: Pse, kur dhe si lindën qytetërimet në Mesopotami, Egjipt, Greqi e Romë; - Identifikon elementet e reja të shoqërive të qytetërimeve antike si organizimet e para shtetërore; - Përcakton qytetërimin e parë që ofroi qeverisje me dinasti mbretërore; - Dallom arritjet e kulturën materiale dhe shpirtërore të qytetërimeve antike në brigjet e lumenjve dhe deteve (Mesopotami, Egjipt, Greqi, Romë); - Kryen veprime për llogaritjen e kohës para dhe pas Krishtit; - Përkufizon konceptet: demokraci, oligarki, republikë, etnos ilir; - Përcakton cilët ishin banorët e hershëm të Ballkanit; - Përcakton vendet se ku janë gjetur gjurmë të hershme ilire; - Përcakton shtrirjen e fenikasve; - Përcakton formën e qeverisjes në Athinë kur u themelua Roma - Vendos kohën kur ra Perandoria Romake e Perëndimit dhe kohëzgjatjen e Perandorisë Romake të Lindjes; - Argumenton lindjen e qytetërimit antik në luginat lumore; - Krahason rolin dhe rëndësinë e shtresave shoqërore (demosi dhe plebnjtë) në Athinën dhe Romën e lashtë; - Dallon pasojat e dyndjeve të popujve në Perandorinë Romake të Perëndimit.

Përcaktimi i peshave në përqindje të çdo tematikave, nëntematikave dhe temave që përmban testi në matricë dhe niveleve të arritjes:

Ndërtimi i tabelës së specifikimit

- Mësuesi duhet të përcaktojë numrin e kërkesave që duhet të përmbajë testi në përputhje me kohën e realizimit të tij.
- Koha e plotë duhet të jetë 45 minuta, pra 1 orë mësimore.
- Testi për tematikën “Qytetërimet botërore në Antikitet. Luginat lumore, djepi i qytetërimeve të hershme (mijëvjeçari IV – II pr. Krishtit)” përmban 15 kërkesa.
- Duke patur parasysh nivelet e arritjeve të rezultateve të nxënimit sipas kompetencave lëndore dhe peshat e përcaktuara sipas niveleve, ndërtojmë tabelën e BLUprintit.
- Për (Nivelin 2), testi përmban 8 kërkesa, pra 40% të kërkesave të përgjithshme të tij,
- për (Nivelin 3), testi përmban 8 kërkesa, pra 40% të kërkesave të përgjithshme të tij dhe
- për (Nivelin 4), testi përmban 4 kërkesa, pra 20% të kërkesave të përgjithshme të tij.
- Në mënyrë të njëjtë veprohet edhe për tematikën “Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut (shekulli VII pr.K. – shekullin V ps. K.)”.

Testi ka 32 pikë gjithsej

1. Qytetërimi i parë që ofroi qeverisje me dinasti mbretërore, ishte: 1 pikë
 - A. Athinas
 - B. Egjiptian
 - C. Babilonas
 - D. Romak

2. Kodi i Hamurabit ishte përpjekja e parë për qeverisje që bazohet në: 1 pikë
 - A. ligj
 - B. dhunë
 - C. frikë
 - D. besim

3. *Vepra letrare më e vjetër njihet:* 1 pikë
 - A. Iliada
 - B. Epi i Gilgameshit
 - C. Odisea
 - D. Tregime për përjetimin e fatkeqësive në det

4. Perkufizo termat e mëposhtëm: 4 pikë

Demokraci _____
Oligarki _____

Republikë _____

Etnos ilir _____

5. Shëno një nga popujt më të hershëm të Ballkanit. 1 pikë

6. Lidh me shigjetë vitet me shekujt në të cilët bëjnë pjesë. 3 pikë

- | | |
|------------------|----------------|
| a. Viti 211 pr.k | Shek. XX |
| b. Viti 365 | Shek. III pr.k |
| c. Viti 1901 | Shek. IV |

7. Plotëso tabelën duke shënuar një nga arritjet e qytetërimeve të mëposhtëme në fushën e shkrimit dhe të ekonomisë. 3 pikë

Qytetërimi	Arritjet
Në Mesopotami	
Në Egjipti	
Fenikas	

8. Pse luginat e lumenjëve Nil, Euftrat, Tiger, Ind, etj, u bënë djepi qytetërimeve të hershme? Argumento përgjigjen. 4 pikë

9. Shkruaj emrat e dy qyteteve të sotme në të cilat janë gjetur gjurmë të qytetërimit ilir. 2 pikë

a) _____ b) _____

10. Në fjalitë e mëposhtëme vendos germën “V” për pohimet e vërteta dhe germën “G” për pohimet e gabuara.

3 pikë

- | | |
|--|-------|
| a) Fenikasit shtriheshin në territoret e Libanit të sotëm. | _____ |
| b) Roma u themelua në vitin 753 pr.k. | _____ |
| c) Egjiptianët përdornin shkrimin kuneiform | _____ |

11. Rendit tre nga pasojat e dyndjeve të popujve në Perandorinë Romake të Perëndimit.

3 pikë

- a) _____
b) _____
c) _____

12. Krahaso rolin dhe rëndësinë e demosit në Athinë dhe plebejëve në Romë. 4 pikë

13. Plotëso fjalinë e mëposhtme. 2 pikë

Perandria Romake e Perëndimit merr fund në shek _____, ndërsa Perandoria Romake e Lindjes do të vazhdojë të ekzistojë edhe për _____ vjet të tjerë.

Skema e vlerësimit të testit

Nota	5	6	7	8	9	10
Pikë	6-10	11-15	16-20	21-24	25 –28	29 – 32

Modele pyetjesh në lëndët Biologji – Kimi (klasa 6 – 9)

2) Qarko pohimin e saktë. Gjuetia ka pakësuar në mënyrë të dukshme popullatën e lepujve. Cili është ndikimi i këtij ndryshimi mbi popullatat e gjarpërinjve dhe fajkojve në këtë ekosistem?

1 pikë

- A) Popullata e lepujve zvogëlohet shpejt;popullata e barit rritet shpejt.
B) Popullata e lepujve zvogëlohet shpejt;popullata e fajkojve rritet shpejt.
C) Popullata e barit zvogëlohet shpejt;popullata e gjarpërinjve rritet shpejt.
D) Popullatat e barit, gjarpërinjve dhe fajkonjve zvogëlohet shpejt.

3)Qarko alternativën e saktë. Cilat nga qelizat e mëposhtme ka mur qelizor? 1 pikë

- A) qeliza nervore
B) qeliza e gjethes
C) qeliza e muskujve

D) qeliza dhjamore.

4) Qarko përgjigjen e saktë. Qeliza bimore ndyshon nga qeliza shtazore sepse ka: 1 pikë

A) kromozom

B) mur qelizor

C) bërthamë

D) citoplazëm

5) Kolona e parë ka proceset jetësore të së gjallës, ndërsa kolona e dytë përshkrimin e tyre. Çiftoni duke vendosur përbri numrit të procesit jetësor shkronjën me përshkrimin përkatës.

5 pikë

	Proceset jetësore	Përshkrimi
1	Jashtëqitje	a.prodhim i individëve të rinj.
2	Riprodhim	b.Ndryshim i pozicionit të një pjesë trupi apo të të gjithë organizmit.
3	Lëvizje	c.Largim i iprodukteve të panevojshme.
4	Tretja e Ushqimit	d.Çlirim energjie në qeliza.
5	Frymëmarrje	e.Marrje e lëndëve kimike për energji dhe rritje.

6) Plotësoni fjalitë e mëposhtme përdorni fjalët në kutinë e fjalëve.

5 pikë

Konsumatorë, marrëdhëniet, pre, alga, veprimtarisë.

- a) Zhdukja e gjallesave ndodh për shkak _____ së njetit, e cila ndikon në ndotjen e ujit, ajrit dhe tokës.
- b) Zinxhirët ushqimorë përdoren për të treguar _____ ushqimore.
- c) Jo të gjithë zinxhirët ushqimorë fillojnë me bimët. Psh.: _____ është prodhues në një habitat detar.
- d) Kafshët që gjuhen ose vriten nga grabitqarët quhen _____ .
- e) Garbitqarët dhe pretë e tyre janë së bashku _____, sepse nuk e prodhojnë vetë ushqimin.

7) Plotësoni fjalitë e mëposhtme me fjalët e duhura:

5 pikë

Zemra është e ndërtuar nga _____, Muskuli i zemrës _____ dhe lëshohet në mënyrë ritmike, duke pompuar gjakun drejt arterieve për ta shpërndarë nëpër trup. Brenda zemrës ndodhen _____ që e lejojnë gjakun të rrjedhë vetëm në një drejtim.

Frymëmarrja aerobe është një process kimik që ndodh në brendësi të qelizave të gjalla.

Reaksioni i përgjithshëm i frymëmarrjes: glukozë + _____ dioksid karboni + _____.

8) E vërtetë (V) apo e gabuar (G). Në fjalitë e gabuara shkruani fjalinë e vërtetë 4 pikë

a) Reaksioni i djegies së magnezit është reaksion endotermik. _____

b) Numri i elektroneve është gjithmonë I barabartë me numrin e protoneve. _____

c) Elementet e grupit VIIA quhen halogjene pasi formojnë baza të forta në bashkëveprim me ujin. _____

d) Efekti termik në reaksionet endotermike është pozitiv. _____

9) Arbi dhe Mimosa vendosën të kryejnë një eksperiment. Ata hodhën 50 cm³ (ml) tretësirë ujore të një baze në një enë konike. Më pas shtuan disa pika të të dëftuesit universal. Nxënësit përdorën një buretë me 50 ml acid 0,1 M për të asnjësuar bazën. Çdo herë shtonin nga 10 ml acid në enën ku ndodhej baza. Arbri e tundte enën konike sa herë shtohet acidi në të. Mimoza shënoi vlerat e pH për çdo vëllim acidi të shtuar. Më poshtë jepet tabela me rezultatet e eksperimentit të tyre.

Vëllimi i acidit të shtuar në ml	0	10	20	30	40	50
---	----------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------

pH i tretësirës	12	11	10	9	8	7
-----------------	----	----	----	---	---	---

a) Cila ishte ngjyra e tretësirës në çastin fillestar? _____ 1 pikë

b) Cila ishte ngjyra e tretësirës në çastin përfundimtar? _____ 1 pikë

c) Tregoni nëse pohimet më poshtë janë të vërteta ose të gabuara? 3 pikë

- Acidi ishte më i fortë se baza. _____

- Baza ishte më e fortë se acidi. _____


- Fortësia e acidit dhe e bazës ishte e njëjtë.

Shpjegoni përgjigjen tuaj në bazë të vlerave të pH-it në tabelën e mësipërme.

d) Vizatoni një grafik për të shënuar rezultatet e dy nxënësve. Në boshtin vertical vendosni vlerat e pH-it. 2 pikë


10) Të jetosh në lartësi të mëdha.

Dihet se në lartësi të mëdha mbi nivelin e detit ka më pak oksigjen, sesa në vende më të ulëta. Nëse një person lëviz me shpejtësi nga një vend më i ulët në një vend më lartë, ai do të ketë vështirësi në frymëkëmbim (do të marrë frymë shpejt) dhe do të ndihet keq. Kjo ndodh, sepse ai nuk mund të marrë mjaftueshëm oksigjen, pra qelizat e trupit të tij nuk furnizohen mjaftueshëm me oksigjen. Megjithatë, nëse ai lëviz pak nga pak në të njëjtin drejtim, domethënë nga poshtë-lart, trupi i tij do të ketë kohën e duhur që t'i përgjigjet ndryshimit të sasisë së oksigjenit duke shtuar numrin e qelizave të kuqe të gjakut. Një grup udhëtarësh menduan të shkojnë nga fshati Fakding te kampi bazë i malit të Everestit në Nepal. Ata planifikuan me kujdes udhëtimin, duke menduar që t'i jepnin mundësi trupit të tyre t'i përshtatej ndryshimit të lartësisë dhe pakësimit të oksigjenit. Plani i tyre pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm.



- a) Përsa ditë u parashikua udhëtimi nga fshati Fakding deri në kampin bazë të Everestit? 1 pikë
-
- b) Sa është lartësia mbi nivelin e detit në fshatin Tekngboke? 1 pikë
-
- c) Sa kohë do të qëndrojnë udhëtarët në këtë fshat, sipas planifikimit të tyre? 1 pikë
-
- d) Shpjegoni pse udhëtarët planifikuan të qëndrojnë disa ditë në Namke dhe në Tekngboke, në vend që të vazhdonin udhëtimin drejt lartësisë. 2 pikë
-
- e) Shpjegoni pse zvogëlohet sasia e oksigjenit në gjakun e udhëtarëve gjatë udhëtimit në ngjitje. 2 pikë
-

11) Dieta dhe ushtrimi fizik. Figura paraqet një dietë ditore që rekomandohet për ata që janë tenistë profesionistë.



Për t'ju përgjigjur këtyre pyetjeve duhet të dini më shumë për dietat e baraspeshuara.

a) Sugjeroni përse dieta e mësipërme përmban shumë drithëra, bukë, oriz dhe makarona. 1 pikë

b) Cila pjesë e dietës përmban proteina?

1 pikë

c) Cila pjesë e dietës përmban hekur?

1 pikë

d) Shpjegoni pse është e rëndësishme një dietë që përmban më shumë hekur, që të jesh në formë fizike. 2 pikë

12) Në tabelën e mëposhtme jepet përmbajtja në gramë e karbohidrateve në disa ushqime.

Ushqimi	Përmbajtja e karbohidrateve në g/100g ushqim	Ushqimi	Përmbajtja e karbohidrateve në g/100g ushqim
Mollë	9	Pulë e pjekur	0
banane	20	Arrë kokosi	4
Bizele	17	Vezë	0
Biskota	66	Peshk	0
buka	45	Mish dele	0
Luleshtrydhe	8	oriz	30

Duke u bazuar në tabelën e dhënë, përgjigjuni pyetjeve:

- Cili nga ushqimet përmban më shumë karbohidrate? _____ 1 pikë
- Eni hëngri 220g banana. Sa gramë karbohidrate mori ajo? _____ 1 pikë
- Orizi nuk përmban glukozë. Cilin lloj karbohidrati përmban ai? _____ 1 pikë
- Cilat janë katër ushqimet që nuk përmbajnë karbohidrate? _____ 1 pikë

13) Qyteti i pakujdesshëm

Në një qytet të pakujdesshëm, është marrë një vendim për të eliminuar vendgrumbullimet e paligjshme të mbeturinave, duke u dhënë banorëve mjetet e përshtatshme për të hedhur mbeturinat. Këshilli i qytetit vendosi të blihen kazanët e mbeturinave, i vendosi ata në vendet e përshtatshme dhe nënshkroi një kontratë me firmën e kontraktuar prej bashkisë për shërbimin e pastrimit. Heqja e taksës së grumbullimit dhe të transportimit të mbetjeve, ndihmoi që publiku të

bashkëpunonte për të hedhur mbetjet shtëpiake në vendin e duhur. Vendgrumbullimet ilegale nuk u shfaqën më.

Pas ca kohësh u pa se sasia e mbetjeve shtëpiake ishte rritur shumë dhe kishte kaluar çdo parashikim. Banorët hidhnin pa kujdes në kazanët e plehrave çdo gjë që nuk u nevojitej më: mbetje bujqësore, si gjethe, kashtë dhe degë të prera pemësh, që mund të kompostoheshin. Këshilli bashkiak vendosi që banorët të paguanin një taksë në varësi të kazanëve të mbushur prej çdo familjeje. Pas futjes së kësaj takse, sasia e mbetjeve u zvogëlua. Kjo rënie mund të ishte edhe si rezultat i menaxhimit të mbeturinave. Por, në fakt, qytetarët kishin filluar t'i digjin këto mbeturina.

Shkarkimet dhe mbetjet e dala prej proceseve të zakonshme të djegies së mbeturinave

Procesi	Llum (kg/t)	Pluhur (kg/t)	Produkte të neutralizimit (kg/t)	Ujë i ndotur (kg/t)	Gaze (m ³ norm.)
E thatë	267	22.5	32.5	-	5,280
Gjysmë e thatë	295	9.2	41.1	-	4,500
E lagësht	296	25.0	3.0	500	5,000

Përfundim: djegia nuk e shkatërron mbetjen. Për më tepër, ajo çon në formimin e përbërjeve të reja, për rrjedhojë, të problemeve të reja.

a) Sa pluhur do të prodhohej për 50 tonë lëndë të thatë të mbetjeve nëse do të digjen?

_____ 1 pikë

b) Djegia e mbetjeve po të vazhdojë, çfarë do të ndodhë me ujin? Pjesa e lagësht e 5000t mbetjeve sa ujë të ndotur do të prodhojë?

_____ 2 pikë

c) Si mendoni ju cila është zgjidhja e duhur për trajtimin e mbeturinave në këtë qytet? Jepni dy zgjidhje të mundshme pa rritur taksat për qytetarët.

_____ 2 pikë

- d) Cili gaz mendoni ju se do të jetë më me shumicë nga djegia e mbetjeve dhe cfare i shkakton në atmosferë rritja e këtij gazi? 2 pikë

V. Ndryshimet pozitive që sjell vlerësimi i bazuar në kompetenca

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar ndryshimet pozitive që sjell vlerësimi i bazuar në kompetenca për nxënësit, mësuesit dhe prindërit.

Për nxënësit	Për mësuesit	Për prindërit
Vlerësimi i bazuar në kompetenca:		
Siguron informacion për pikat e forta dhe mundësitë për zhvillim.	Siguron të dhëna të hollësishme për aspekte të ndryshme të nxënësit.	Siguron informacion të detajuar dhe specifik për arritjet e fëmijës.
Mbështet dhe nxit procesin e të nxënësit.	Krijon mundësi të gjykojë më mirë për arritjet e nxënësve.	Krijon mundësi që prindërit të përfshihen në procesin e të nxënësit të fëmijës.
Lehtëson nxënësit dhe shmang presionin e notës në mënyrë të vazhdueshme.	Lehtëson vëmendjen e tij nga notat e vazhdueshme duke u përqendruar më shumë te të nxënësit e nxënësve.	Krijon më shumë mundësi për mbështetje rreth të nxënësit të fëmijëve të tyre.
Ç bën “mitin” e notës.	Shmang subjektivizmin në vlerësim.	Krijon mundësi që prindërit të interesohen më shumë për përparimin e nxënësve në vazhdimësi.
Siguron vetëbesim te nxënësit.	Siguron të dhëna nga burime të ndryshme për të motivuar nxënësin.	Krijon mundësi që të vlerësohen jo vetëm arritjet, por edhe përpjekjet që bëjnë fëmijët e tyre.
Krijon mundësi për vetëvlerësim dhe forma të larmishme vlerësimi.	Me organizimin e veprimtarive gjithëpërfshirëse gjatë zhvillimit të mësimit me dy orë	Krijon mundësi që prindërit të japin mendimin e tyre për vlerësimin e fëmijës së tyre.

	të njëpasnjëshme lehtësohet shumë si proces.	
Motivon zhvillimin e kompetencave të nxënësve (kompetencave kyçe dhe lëndore).	Nxit rritjen profesionale të mësuesit.	Krijon mundësi që fëmijët e tyre të aftësohen edhe në zgjidhjen e situatave në jetën e përditshme.
Bazohet në nivele arritjesh të njëjta për të gjithë.	Krijon mundësi që mësuesi të jetë objektiv dhe transparent për të gjithë.	Krijon mundësi që prindërit të ndërgjegjësohen për vlerësimin e fëmijës së tyre.
Zhvillon talente dhe u jep mundësi të gjithë nxënësve të tregojnë aftësitë e tyre.	Siguron gjykime dhe mbështet vendimmarrje mbi bazën e të dhënave të shumta që siguron.	Krijon mundësi që prindërit të sigurojnë informacione mbi bazën e të dhënave që mësuesi siguron nga burime të ndryshme.
E bën nxënësin më “miqësor” me lëndën.	E bën lëndën më “të dashur” për nxënësin.	E bën shkollën dhe mësuesit më “të pëlqyeshëm” për fëmijët e tyre.

VI. Fjalorth për vlerësimin e nxënësit

<i>Nr</i>	<i>Termet</i>	<i>Përkufizimi</i>
1.	Besueshmëri në vlerësim	Masa në të cilën një vlerësim, i përsëritur në kushte të ngjashme, do të arrijë të njëjtin rezultat.
2.	Nivel arritjeje	Një deklaratë që përcakton masën në të cilën është arritur rezultati i të nxënësit ose nivelin e njohurive dhe të kompetencave kyçe.
3.	Paanshmëri në vlerësim	Paanshmëria në vlerësim i referohet nevojave dhe karakteristikave të nxënësit dhe çdo mjeti të arsyeshëm që përdoret duke i marrë parasysh ato. Është e rëndësishme që të

		sigurohen mundësitë që nxënësi të informohet, të kuptojë, të marrë pjesë në procesin e vlerësimit dhe ta pranojë e miratojë atë si të përshtatshëm. Paanshmëria në vlerësim përshin edhe të drejtën e nxënësit për të kundërshtuar rezultatin e vlerësimit dhe të rivlerësohet, nëse shihet e nevojshme.
4.	Përgjegjësi dhe llogaridhënie	Proces në të cilin aktorët njohin, marrin përgjegjësi dhe japin llogari për vendimet, veprimet dhe pasojat e tyre. Llogaridhënia është e rëndësishme sidomos në kontekstin e decentralizimit të sistemit arsimor, i cili nxit autonominë shkollore, duke përfshirë edhe vendimet në lidhje me kurrikulën.
5.	Rezultat të nxëni	Termi ka kuptim të dyfishtë. Së pari, është deklaratë që përshkruan atë se çfarë duhet të dinë, të vlerësojnë dhe të jenë në gjendje të bëjnë si duhet nxënësit. Së dyti, u referohet njohurive të reja, kompetencave etj., që ndërton dhe përsos personi/grupi, pasi përmbyll nivelin arsimor. Rezultati i të nxënit është koncept kyç për hartimin e mjeteve që mundësojnë transparencën, krahasimin, transferimin dhe njohjen e kualifikimeve në mes vendeve të ndryshme, në nivele të ndryshme.
6.	Teknikë vlerësimi	Teknika e vlerësimit ka të bëjë më mënyrën se si vlerësohen arritjet e nxënësve, e cila përfshin matjen direkte (teste, punët e nxënësit, detyrat, prezantimet, dosjen etj.) dhe matjen indirekte (vetëvlerësime, vëzhgime, intervista etj.)
7.	Test	Një provim ose vlerësim që përdoret për të matur njohuritë dhe shkathtësitë e fituara nga nxënësi. Testet mund të hartohen dhe zhvillohen nga mësuesit ose nga një agjenci e jashtme.

8.	Testim standardizuar	i	Teste që hartohen, zhvillohen dhe vlerësohen në kushte të barabarta, sipas disa procedurave të hartuara në mënyrë të tillë që të sigurojnë rezultate të qëndrueshme, të cilat mund të shërbejnë për të bërë krahasime.
9.	Vlerësim		Vlerësimi në arsim është procesi gjatë të cilit gjykohet mbi bazën e një kriteri për vlerën e një rezultati arsimor, mbi bazën e informacioneve të grumbulluara nga procesi i të nxënit.
10.	Vlerësim për nxënit/Vlerësim formues	të	Vlerësim i kryer gjatë gjithë procesit mësimor me qëllim nxitjen e procesit të të nxënit. Ky vlerësim e sheh të nxënit si proces e jo vetëm si rezultat. Nxënësit ndërgjegjësohen për pikat e forta dhe nevojat në procesin e të nxënit dhe u jepet mbështetja e duhur për të kapërcyer vështirësitë në procesin e të nxënit.
11.	Vlerësim i nxënit/Vlerësim përmbledhës	të	Vlerësim i arritjeve të nxënësve për të siguruar informacion në lidhje me progresin e tyre (arritjet e tyre në fusha të ndryshme të kurrikulës /lëndëve mësimore dhe zotërimin e kompetencave). Ky proces shpesh përfshin përdorimin e testeve të standardizuara dhe përdoret për qëllime promovimi ose diplomimi.
12.	Vlerësim performancës nxënësit	i së	Vlerësim që projektohet për të matur dhe gjykuar çfarë nxënësit dinë dhe janë të aftë të bëjnë duke u bazuar në mënyrën se si ata kryejnë detyra të caktuara.
13.	Vlerësim brendshëm	i	Vlerësimi që kryhet rregullisht nga mësuesit në klasë si pjesë e mësimin të tyre dhe e metodologjisë së mësimdhënies. Ai ofron informacion rreth cilësisë së të nxënit dhe mbështet përmirësimin e tij të vazhdueshëm.
14.	Vlerësim që referohet kriterëve	i	Vlerësim i progresit dhe i arritjeve të nxënësit duke iu referuar një grupi kriteresh të përcaktuar më parë.
15.	Vlerësim diagnostikues		Vlerësim që identifikon nivelet e arritjeve të nxënësve, për të orientuar mësimin drejt plotësimin nevojave të tyre për nxënie.

16.	Vlerësim kombëtar i arritjeve të nxënësve	<p>Një ushtrim, një detyrë ose një veprimtari që zhvillohet në nivel kombëtar për të përcaktuar dhe matur arritjet e nxënësve në një fushë të nxëni ose lëndë mësimore. Në këtë lloj vlerësimi mblidhen të dhëna për nivelin e arritjeve të nxënësve në sistemin arsimor në tërësi, në një moshë ose klasë të caktuar.</p> <p>Normalisht këtu përfshihet edhe administrimi i testimit që zhvillohet për të gjithë nxënësit e një niveli arsimor ose për një pjesë të tyre (me kampionim).</p>
17.	Vlerësim i jashtëm	<p>Një proces dhe metodë vlerësimi që e zhvillon dhe e përdor një agjenci apo organ vlerësues (jo shkolla). Ky proces zakonisht përfshin testimin e standardizuar dhe shpesh shërben për të klasifikuar kandidatët për mundësitë e mëtejshme arsimore dhe për qëllime certifikimi.</p>
18.	Vlerësim i nxënësve për njëri-tjetrin	<p>Vlerësim i një pune ose një detyrë të nxënësit nga nxënësit e tjerë të klasës.</p>
19.	Vlerësim i portofolit (dosjes) të nxënësit	<p>Vlerësim i koleksionit të punimeve të nxënësit (detyra ose punë me shkrim, skica, punë artistike, prezantime etj.), të cilat pasqyrojnë zotërimin e kompetencave dhe progresin e nxënësit.</p>
20.	Vetëvlerësim i të nxënit	<p>Vlerësim nga i cili nxënësi mbledh informacion dhe reflekton rreth të nxënit e tij; gjykon për të në raport me objektivat dhe kriteret e vendosura; identifikon përparësitë e dobësitë dhe i përmirëson në përputhje me rrethanat.</p>

VII. Bibliografia

- IZHA, 2014, Korniza kurrikulare.
- IZHA, 2014, Kurrikula bërthamë AMU, klasat 6-9.
- IZHA, 2014-2018, Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat 6-9
- IZHA, 2015, Korniza e vlerësimit të nxënësit.
- IZHA, 2016, Nivelet e arritjes (arsimi bazë).
- IZHA, 2017, Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët.
- OECD, Programme for International Student Assessment (PISA).